



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Teknologji Informacioni
dhe Komunikimi”
Kolegji Universitar “Bedër”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



Prof. Asoc. Ana KTONA

Dr. Miranda HARIZAJ

Korrik / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bsc në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”**

| | | |
|----|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar “Bedër” |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave Kompjuterike |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bsc në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër Nr. 426, datë 18.07.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 10 PAE / 10 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 42 studentë (për një cikël të plotë studimi) |
| 19 | Komente / të tjera: | - |



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Kolegji Universitar Bedër ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2012, pas liqensimit të tij me VKM Nr. 286, datë 6.04.2011. Me Urdhër Nr. 223, datë 4.06.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është realizuar akreditimi i parë për institucionin. Institucioni riorganizohet në dy njësi kryesore, me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 200, datë 03.07. 2020, përkatësisht:

1. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit;

IAL ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.101, datë 10.11.2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike.

Me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr.426, datë 18.07.2018, hapet programi i studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, pjesë e Fakultetit Filologjisë dhe Edukimit, i cili pas riorganizimit të fundit është pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit. Aktualisht programi ka hyrë në procesin e akreditimit. Kohëzgjatja e tij normale është 3 vite dhe numri krediteve të tij është 180 ECTS.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, ofruar nga Kolegji Universitar Bedër. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr. 4, Datë 18.01.2021 "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë, aplikuar nga Kolegji Universitar 'Bedër' dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të parë të studimeve.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.As. Ana Ktona dhe Dr. Miranda Harizaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Kolegji Universitar Bedër, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", e përbërë nga 118 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datë 1 Mars 2021, në Institucion sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standardeve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar Bedër".

Kolegji Universitar "Bedër", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.06.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 33/13 Prot, datë 07.06.2021. Kolegji Universitar "Bedër", përcjell në ASCAL më datë 14 Qershor, me anë të shkresës me Nr. 63/11 Prot, datë 11.06.2021 "Komente në lidhje me draft raportin".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- Lidhur me komentin 1 që ka përcjellë Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të IAL, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm ka këto qëndrime:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.5 Kriteri 1;**

Në tabelën e përfshirë në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat 12 "*Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës*", mbulimi me personel akademik efektiv të ngarkesës mësimore në auditor për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, janë në përputhje me VKM Nr. 418 dt. 10.05.2017, pasi tabela e përdorur si referencë në RVB ka të cituar vetëm titullarët e lëndëve me kohë të plotë dhe të pjesshme. Në mbështetje të kësaj, bashkëngjitur do të gjeni Tabelat 12 të detajuara dhe të përditësuara me ngarkesën mësimore të shpërndarë tek lektorët dhe asistentë lektorët me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Argumenti i GVJ: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ përpara vizitës dhe gjatë vizitës në institucion, është konstatuar që mbulimi me personel akademik efektiv të ngarkesës mësimore në auditor për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informatik dhe Komunikimi, nuk është në përputhje me VKM Nr. 418 dt.10.05.2017.

GVJ konstaton se tabelat e dërguara bashkë me komentet në dokumentin: ‘Evidencë mbështetëse nr.1 Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkatës (Tabelat 12), të përditësuara nuk janë të njëjta me tabelat e dërguara në dokumentin: RVB Teknologji informatik dhe komunikimi Tabelat 12 Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkatës. **Për sa më sipër vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.**

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin IV.3, Kriteri 4;**


Gjatë vizitës në institucion në kushtet e pandemisë dhe në kushte kur laboratorët e informatikës nuk përdoren nga studentët, në PC-të e laboratorëve kanë qenë të instaluar disa nga software-ët më të domosdoshëm për referencë dhe përdorim nga grupe të vogla studentësh. Aktualisht janë instaluar software-ët për të gjitha lëndët dhe laboratorët janë gati për të zhvilluar mësimin normalisht. Në mbështetje të kësaj, bashkëlidhur do të gjeni raportin e instalimit të software-ëve.

Argumenti i GVJ: Konstatimet dhe rekomandimi i GVJ se softuerët e përdorur në laboratorë, duhet të përditësohen në përputhje me kërkesat e lëndëve të programit të studimit të cilat i referohen dokumentacionit dhe konstatimeve gjatë vizitës në IAL, qëndrojnë dhe mbështeten nga sqarimet dhe informacionit të ri i dhënë nga IAL së fundmi. **Për sa më sipër vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.**

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardet III.3, Kriteri 4 dhe IV.4, Kriteri 2;**

Në RVB është dërguar bashkëlidhur “Evidenca nr.53 Projekt buxheti i Departamentit të Shkencave Kompjuterike”, ku citohet edhe zëri për plotësimin e literaturës së re për programet e studimit. Në vazhden e kësaj, janë porositur librat e literaturës bazë dhe të detyrueshme për rreth 30 lëndë, nga të cilat një pjesë ka mbërritur tashmë. Institucioni është në pritje të marrjes së pjesës tjetër të literaturës për të qenë pjesë e kopjeve fizike në bibliotekën e universitetit.

Argumenti i GVJ: Konstatimet dhe rekomandimi i GVJ për pasurimin e literaturës fizike për lëndët e programit të studimit të cilat i referohen dokumentacionit dhe konstatimeve gjatë vizitës në IAL qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga sqarimi dhe informacioni i ri, i vënë në dispozicion nga institucioni së fundmi. **Për sa më sipër vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”””

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

| Standardi I.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Universitar “Bedër”, GVJ konstaton se programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Misioni i Kolegjit Universitar “Bedër”, të përgatitë individë të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Pjesë e misionit të Kolegji Universitar “Bedër”, është të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Gjithashtu, misioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, që ka si program Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, është t’i përgatisë studentët me njohuri bazë aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialist me kompetenca të zgjedhura praktike në fushat e implementimeve të sistemeve informatike si dhe të operojnë specialistë në lidhje me nevojat e teknologjisë së informacionit në sektorin publik apo privat.</p> <p>[dok DVV Evidenca 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4, pika 1;][https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-departamentit-9-8-15/651/652]</p> |
| Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | <p>Nga shqyrtimi i statutit të Kolegji Universitar “Beder” dhe planit strategjik vlerësohet se programet e studimit, përfshirë programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [dok DVV Evidenca 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4]</p> |
| Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Bedër”.</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | [dok DVV Evidenca 10 Plani Strategjik 2016-2020, Misioni & Profili i Kolegjit Universitar “Bedër”; dok DVV Evidenca 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4;] | | | |
| Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | <p>Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit.</p> <p>Në Planin Strategjik të tij thuhet shprehimisht: “Kolegji Universitar “Bedër” synon të shndërrohet në një institucion arsimor me karakter ndërkombëtar, duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të huajt, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qendër rajonale e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”. Për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në përputhje me strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi, është paraqitur një analizë mbi perspektivën e shkencave kompjuterike dhe teknologjive të informacionit realizuar nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Nga website i Kolegjit Universitar “Bedër” citojmë: programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialistë me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike, që ata të operojnë si specialistë dhe t’u përgjigjen nevojave në sektorin publik ose privat ku janë të angazhuar.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 14 Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”]</p> <p>[https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.2



Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | <p>GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit në të cilën teknologjia e informacionit është përcaktuar si një nga fushat ku KUB ofron programe studimi.</p> <p>[dok DVV Evidenca 10 Plani Strategjik 2018-2023; Profili i Kolegjit Universitar “Bedër”]</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|--|
| <p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> | <p>Statuti i KUB përcakton qartë drejtimet prioritare akademike të tij. Në thuhet shprehimisht se: Kolegji Universitar Jopublik “Bedër”, në të gjithë veprimtarinë e tij, ka për qëllim të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e shkencave islame, jurisprudencës, shkencave të komunikimit, ekonomisë, biznesit, teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike, shkencave të edukimit, gjuhëve të huaja, duke zhvilluar programe studimi në profilet përkatëse në auditorë .Rregullorja e programit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] [dok DVV Evidenca 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themlore; dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja mbi Organizimin Akademik]. [dok DVV Evidenca 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4, pika 2.a;]</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p> | <p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, emërtohet, organizohet, strukturohet dhe ka përmbajtje në përputhje me fushën akademike teknologji e informacionit e cila është një prej fushave/drejtimeve akademike të KUB.</p> <p>[dok DVV Evidenca 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;]</p> | | | |
| <p>Shkallia e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi I.3</p> <p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p> | |
| <p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të publikuar në website të KUB, GVJ konstaton se në programin e studimit përshkruhen qartë objektivat e mësimdhënies dhe se ky program realizohet në përputhje me këto objektiva. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se programi i studimit Bsc në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, është hapur në përputhje me kërkesën e tregut për specialist të kësaj fushe të konstatuar nga institucioni në studimin e tregut.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 14</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617 | | | |
| Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Institucioni ka realizuar studimin për tregun e punës përpara hapjes së programit. Në këtë studim përfshihet informacion mbi kërkesat e punëdhënësve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mundësitë e punësimit të studentëve të programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin me kohë të pjesshme të studentëve, të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", jepen në dokumentin e siguruar gjatë vizitës në KUB. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin e studentëve të diplomuar në KUB jepen në dokuemntin. [dok DVV Evidenca nr. 18 Raport i Zyrës së të Diplomuarve, viti 2019-2020] [dok DVV Evidenca nr. 14 Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”] | | | |
| Kriteri 3. Objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 35 Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit ; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617] [dok DVV Evidenca nr. 14 Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi I.4 | |
| Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike | GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion, se KUB ka përvojën (eksperiencë 10 vjeçare në fushën akademike), kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit. Personeli akademik në programin e studimit është i kualifikuar, me një |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p> | <p>përvojë shumëvjeçare në këtë fushë studimore dhe aplikative, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Referuar të dhënave tabelore në RVB, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 32 pedagogë, nga të cilët 21 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr., dhe 12 Asistent Lektorë me Msc, dhe 11 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 3 kanë gradën Dr. dhe 8 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka 7 PAE dhe 11 PAK.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej vitit 2018. Kjo njësi kryesore ofron gjithashtu dy programe të tjera në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike: Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" dhe Program Profesional 2 vjeçar "Programim në Web". Programi Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ka si fushë të përgjithshme dhe specifike fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, fushën e teknologjisë.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr.:33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;</p> <p>https://www.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-fakultetit-7-15/657/658]</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p> | <p>Programi Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është Teknologjia e Informacionit. Kjo fushë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; https://www.beder.edu.al/sh/content/default/departamenti-i-shkencave-kompjuterike-10-6/657/590]</p> |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloret e tij. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor ne "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 35 Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit; dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Dokument nga vizita në institucion: Raporti i NJSBC 2019-2020; Raporti Vjetor Institucional 2019-2020] [dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themlore; dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja mbi Organizimin Akademik;]</p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p> | <p>GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "Beder" ka bashkëpunime ndërinstitucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 26 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU; dok DVV Evidenca nr. 25 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani dhe Kroaci; Dokument nga vizita në institucion: IT COMP lista e kompanive per praktika;]</p> |
| <p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të</p> | <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", në raportin vjetor të tij paraqet një analizë të bashkëpunimit me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020;]</p> |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| realizimit të programeve të studimeve. | | | | |
| Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | <p>GVJ konstaton se, KUB ka marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me disa institucione, organizata dhe biznese te ndryshme për kryerjen e praktikave profesionale. Studenteve u ofrohet mundësia për të shprehur kërkesat e tyre për punëdhënësin ku dëshirojnë të realizojnë praktikën. Praktika mund të realizohet edhe te një punëdhënës me të cilin institucioni nuk ka marrëveshje zyrtare. Institucioni nis kërkesën për bashkëpunim nëpërmjet një komunikimi shkresor me punëdhënësit për realizimin e praktikave. Në fund të realizimit të praktikës përgatitet një raport si nga punëdhënësi dhe nga studenti.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 29 Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale] [Dokument nga vizita në institucion: Raporti I Praktikës Per Punedhenesin; Raporti I Praktikës Per Studentin] [dok DVV Evidenca nr. 26 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU; Dokument nga vizita në institucion: Shenimet gjate vizites, Beder; IT COMP lista e kompanive per praktika;]. [dok DVV Evidenca nr. 31 Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale]</p> | | | |
| Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | <p>Programi Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 dhe si i tillë nuk ka realizuar akoma trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Sipas RVB, Departamenti i Shkencave Kompjuterike në bashkëpunim me kompaninë ATOM Computers po planifikon hapjen e Qendrës së Certifikimeve, e cila synon trajnimin në fusha specifike kompjuterike, nënshtrimin ndaj provimit përkates rigoroz të monitoruar dhe marrjen e certifikimit përkates ndërkombetar.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |





II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| Standardi II.1 | |
|---|--|
| Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total 180 kredite.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018]</p> |
| <p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p> | <p>Programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” synon t’i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialistë me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike. GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimit e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. Studimi i Tregut evidentoi disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi.</p> <p>[https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617] [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] [dok DVV Evidenca nr. 14 Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”]</p> |
| <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, u jep njohuri studentëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Ndër synimet kryesore të programit është edhe, përgatitja e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, të gatshëm për t’u përballur me kushtet e një</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>tregu të hapur global në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe sistemeve kryesore të mbështetura prej tyre, përmes kombinimit të teorisë me praktikën.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Evidenca nr. 32 Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Kerkesë Per Hapjen Dhe Ose Organizimin E Programeve Te Studimit”; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617]</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” synon, ndër të tjera: përgatitjen e studentëve me njohuritë bazë mbështetëse teorike dhe praktike në funksion të teknologjisë së informacionit, njohjen e studentëve me teknologjitë konkrete që përdoren së fundmi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, njohjen e studentëve me bazat e konceptimit dhe implementimit të hardware-ve mbështetës të sistemeve informatike. GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 32 Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “KERKESE PER HAPJEN DHEOSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT”; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617]</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;]</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> | <p>GVJ konstaton se Programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj, të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 32 Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “KERKESE PER HAPJEN DHEOSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT”; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617]</p> |




| | | | | |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Nga shqyrtimi i programit mësimor, rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. Përqindja sipas secilit tip të komponentit mësimor është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndët bazë 20% • lëndët karakterizuese 54% • lëndët ndërdisiplinore 12% • lëndët plotesuese 10% • detyrimet përmbyllëse 4% <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi II.2



Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 101, datë 10. 11. 2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. Njësitë kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër” janë riorganizuar me Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër”.</p> <p>Rezultoni se Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamentin e Shkencave Kompjuterike; • Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit; • Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshem dhe Inovacion; <p>[dok DVV Evidenca nr. 2 Urdhër nr 223, datë 4.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”; Evidenca nr. 21 Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit]</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoni se Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe</p> |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| <p>person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p> | <p>Komunikimi” zgjedh koordinatorin e programit të studimit me vendim të Keshillit të Departamentit. Sipas RVB, koordinatori i programit të studimit është funksion ndihmes akademik me karakter administrativ. Ai kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarevajtjes së programit.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 34 Vendimi për caktimin e Koordinatorit të Programeve Bachelor, viti akademik 2020-2021.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>Njësia kryesore “Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit” është riorganizuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër”. Ky Fakultet ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamentin e Shkencave Kompjuterike; • Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit; • Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshem dhe Inovacion; <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike ofron studime në tre programe, një program me karakter profesional dhe dy të ciklit të parë bachelor. Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Prof. As” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”.</p> |
| <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> | <p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit në vitin e fundit akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij 32 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 21 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 11 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021:</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p><u>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; - 0 PAK; <p><u>Departamenti i Shkencave Kompjuterike:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; - 11 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada; <p><u>Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; - 0 PAK; |

| | | | | |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Shkencave Kmpjuterike që është përgjegjës për programin e studimit për vitin akademik 2020-2021 është: 7 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 3 me grada shkencore dhe 11 staf akademik me kontratë (PAK), nga të cilët 3 me grada shkencore.</p> <p>Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>[dok DVV RVB shtojca 1 Shtojca nr. 1: Numri i personelit akademik për pdo njësi baze: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontrate (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmes Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.3



Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | |
|--|--|----------------|------------|----------------|------|---|---|------------|---------|----|-----|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>GVJ konstaton se Departamenti Teknologjisë dhe Biznesit disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren, programin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi], syllabuset [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] Ngarkesën [Dokumente nga vizita në institucion: 14- Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik</p> | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> | <p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën mëposhtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Pershkrimi</th> <th>% sipas VKM 41</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZË</td> <td>15%-20%</td> <td>36</td> <td>20%</td> </tr> </tbody> </table> | Kategoria | Pershkrimi | % sipas VKM 41 | ECTS | % | A | LËNDË BAZË | 15%-20% | 36 | 20% |
| Kategoria | Pershkrimi | % sipas VKM 41 | ECTS | % | | | | | | | |
| A | LËNDË BAZË | 15%-20% | 36 | 20% | | | | | | | |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



| | | | | | |
|--|--|---|-----------|----|-----|
| | B | LËNDË KARAKTERIZUESE | 50% - 55% | 98 | 54% |
| | C | LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGR UESE | 12%-15% | 21 | 12% |
| | D | LËNDË PLOTËSUESE(Praktika) | 10% | 18 | 10% |
| | E | DETYRIME PËRMBYLLËSE | 3%- 5% | 7 | 4% |
| | <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban 30 lëndë + Praktikën + Provimin Përfundimtar. Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator). [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> | | | | |
| Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në 6 semestra e tre vite akademike dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit. Ky program rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe 180 kredite në total.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi].</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;]</p> | | | | |
| Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohet te syllabuset [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;]</p> | | | | |
| Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se 'Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi dhe rregullorja e transferimit të studimeve, përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregullorja e programit: Kriteret e pranimit të studentëve</p> | | | | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MASR, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen në portalin U-Albania i cili është i aksesueshëm nga institucionet. Kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës është në masën 30%.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Neni 5; Evidenca nr. 80 Rregullorja e Transferimit të Studimeve]</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, dt. 24. 01. 2018. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve, ngarkesën javore si dhe detyrimet lëndore.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p> | <p>GVJ konstaton se, programi i studimit është në përditësim: propozohen ndryshime në kurrikulen e programit të studimit nga njësia bazë dhe miratohen nga Senati Akademik. Sipas RVB, stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 38 Praktika e ndryshimit në kurrikul]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

Standardi II.4



Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrës Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve, rezultateve të nxënies dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> | <p>GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total. GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> |


| | |
|---|---|
| | [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] |
| Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | <p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Praktikrat në institucione të ndryshme ju mundësojnë studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e studentëve.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 29 Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale; Vizita në institucion]</p> |
| Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Lëndët japin aftësi teknike të fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si siguria, menaxhimi i bazës së të dhënave, rrjetat, telekomunikimi, Programimi Web etj. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në të gjashtë semestrat e realizimit të programit është e balancuar me 30 kredite për çdo semester. Numri i orëve mësimore për semestrin I, II, III është 24 orë në javë në auditor, për semestrin IV dhe V 20 orë në javë në auditor dhe për semestrin e VI-të 18 orë në javë në auditor.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit dhe, rrjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në fushën Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, dhe se raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe | Gjatë intervistave më personelin akademik dhe me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit |

| | |
|--|--|
| <p>raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në këtë program studimi 1200 orë në auditor janë leksione, 210 orë në auditor janë seminare, 480 orë në auditor janë laboratore dhe 60 orë janë praktikë. Numri i orëve për diplomën është 15 dhe numri i orëve për studim individuale është 2514.</p> <p>Raporti teori/praktikë në auditor është 62% me 38%.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se syllabuset ngarkohen në sistemin informatik Beder Information System (BIS) bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar edhe literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit. Sipas RVB, syllabuset ngarkohen në fillim të çdo semestri vitit akademik.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> | <p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli bachelor. Disa nga lëndët që ofrojnë aftësi teknike nga më të kërkuarat për profesionistët e IT-së janë: Sisteme të Informimit dhe Komunikimit, Bazat e të dhënave, Rrjete Kompjuterike, Sistemet Operative, Strukturë të dhënash, Programim i Orientuar nga Objektet, Programim Java, Programim në WEB, etj</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi u jep mundësi studentëve të vijnë studimet e mëtejshme në programet e ciklit të dytë dhe të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi dhe kompetenca në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> |






| | | | | |
|---|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| | [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Evidenca nr. 14 Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.pdf] | | | |
| Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | GVJ gjatë takimeve në institucion, konstatoi se janë organizuar takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës duke i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve eventuale të mundshëm. Gjithashtu u konstatua një bashkëpunim shumë i ngushtë me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës të cilët ishin ftuar të jepnin mësim. [dok DVV Evidenca nr. 27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite] | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi II.5 | |
| Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Referuar dokumentit [RVB Teknologji informacioni dhe komunikimi Tabelat 6.1, 6.2 dhe 6.3], të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë: Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 20 pedagogë ndër të cilët 10 PAE dhe 10 PAK. Mbulimi i programit në përqindje është 50% PAE dhe 50% PAK. Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 13 pedagogë ndër të cilët 4 PAE dhe 8 PAK. Mbulimi i programit në përqindje është 35% PAE dhe 65% PAK. Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 9 pedagogë ndër të cilët 5 PAE dhe 4 PAK. Pika 6 e nenit 59 të ligjit 80/2015 përbushet. Mbulimi i programit në përqindje është 55% PAE dhe 45% PAK. Referuar ngarkesës totale të personelit akademik rezulton se PAE mbulon 63.5% të ngarkesës totale të programit dhe PAK 36.5% të |






| | |
|---|--|
| | <p>ngarkesës totale të programit. Ndërsa në lidhje me ngarkesën mësimore te të gjitha programet PAE mbulon 73% të ngarkesës dhe PAK 27%.</p> <p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon, që institucioni duhet të marrë masa për të rritur numrin e stafit akademik efektiv, për të mbuluar në masën 70% ngarkesën mësimore në auditor për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe komunikimi, konform VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</i></p> <p>[RVB Teknologji informacioni dhe komunikimi Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik te programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ne nje vit akademik]</p> <p>[Dokumente nga vizita në institucion: 14-Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik]</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Modulet mësimore mbuloohen nga pedagogë të cilët kanë gradë shkencore doktor ose janë MSc. Për sa i përket kualifikimeve te personelit akademik, Referuar dokumentit [RVB Teknologji informacioni dhe komunikimi Tabelat 6.1, 6.2 dhe 6.3] konstatojme se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për 2020-2021, 25% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 75% janë Msc; - Për 2019-2020, 30% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 70% janë Msc; - Për 2018-2019, 33% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 67% janë Msc. <p>[Dokumente nga vizita në institucion: 14-Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik;]</p> <p>[dok DVV nr. 20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka njohuri në përputhje me natyrën e programit. Rezulton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës teknologji informacioni dhe komunikimime me aftësi tepër të larta. Referuar dokumentit [RVB Teknologji informacioni dhe komunikimi Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik te programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ne nje vit akademik] PAE mbulon 63.5% të ngarkesës totale të programit dhe PAK 36.5% të ngarkesës totale të programit, ndërsa në lidhje me ngarkesën mësimore te të gjitha programet PAE mbulon 73% të ngarkesës dhe PAK 27%.</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | [dok DVV nr. 20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Dokumente nga vizita në institucion: 14-Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik; RVB Teknologji informacioni dhe komunikimi Tabela 4] | | | |
| Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Kolegji Universitar Bedër ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit public. Në fillim të çdo viti akademik, çdo departament zgjedh një këshilltar karriere me vendim të Këshillit të Departamentit pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës e cila ndër të tjera organizon takime prezantuese të studentëve të diplomuar dhe institucioneve të sektorëve të ndryshme për informimin e studentëve me profesionet përkatëse, eksperiencat e punës dhe mundësitë e karrierës. Në RVB tabela 6.3 është përcaktuar gjithashtu lista e stafit akademik udhëheqës i diplomave. [dok DVV Evidenca nr. 26 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU;] [dok DVV Evidenca nr. 23 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës] | | | |
| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Gjatë vizitës në ambientet e shkollës (klasat /labororet ku bëhet mesim nga studentet e këtij programi) GVJ konstatoi se mirëmbajtja e laboratorëve kryhet nga IT i cili nga shqyrtimi i CV-ve ka kualifikimin e duhur për mirëmbajtjen e laboratorëve. [Vizita në institucion: Shenimet gjate vizites, Beder; dok DVV nr. 20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1 | |
|---|--|
| Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> | <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se KUB në nivel institucional harton udhëzues, manuale dhe organizon trajnime të vazhdueshme për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 40 Guida e Stafit; Evidenca nr. 43: Udhezim mbi mesimdhënien ne distance; Evidenca nr. 42: Udhezimi mbi funksionimin e Bibliotekes; Evidenca nr. 49 Lista e trajnimeve për stafin]</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse në KUB, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ka zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerëson në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi dhe vlerësimi i stafit mësimdhënës realizohet nëpërmjet anketave prej të cilave merret informacion në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor, metodat e përdorura për mësimdhënie, etj.</p> <p>[Dokument nga vizita në institucion: Raporti i NJSBC 2019-2020; Anketa E Studentit Për Lëndën Dhe Pedagogun E Përditësuar; Formati I Pyetësorit Të Studentit I Plotësuar]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësor në fund të çdo semestri. Gjatë vizitës në institucion GVB dhe studentët u shprehën se kur ka pasur ankimime ato janë trajtuar.</p> <p>[Dokument nga vizita në institucion: Raporti i NJSBC 2019-2020; Anketa E Studentit Për Lëndën Dhe Pedagogun E Përditësuar; Formati I Pyetësorit Të Studentit I Plotësuar;]</p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në KUB. NJSBC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport në nivel institucioni.</p> <p>[Dokument nga vizita në institucion: Raporti i NJSBC 2019-2020; Anketa E Studentit Për Lëndën Dhe Pedagogun E Përditësuar; Formati I Pyetësorit Të Studentit I Plotësuar;]</p> |



| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>KUB ka disa mekanizma vlerësimi për personelin akademik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formulari i Anketave vetëvlerësuese të stafit akademik, plotësohet nga personeli akademik dhe kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës; • Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik. Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur; <p>Sipas RVB, vlerësimi dhe promovimi i praktikave të mira bëhet nga eprorët në raportet vjetore të njësive të ndryshme akademike dhe administrative të institucionit dhe në takimet me personelin akademik dhe administrativ.</p> <p>[Dokument nga vizita në institucion: Anketa E Studentit Për Lëndën Dhe Pedagogun E Përditësuar; Formati I Pyetësorit Të Studentit I Plotësuar;]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| <p>Standardi III.2</p> | |
|---|---|
| <p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KUB, GVJ konstaton se personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Syllabuset e lëndëve miratohen në department.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe</p> | <p>Gjatë vizitës në KUB GVJ konstatoi se personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Personeli akademik ka ndjekur udhëzimin mbi mësimdhënien në distancë dhe ka përshtatur format dhe metodat e mësimdhënies për t’ju përshtatur situatës së krijuar nga pandemia.</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> | <p>[dok DVV Evidenca nr. 43: Udhezim mbi mesimdhënien ne distance; Vizita në Institucion;]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> | <p>GVJ konstaton se KUB angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. Ai zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike.</p> <p>GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite; https://cmp.beder.edu.al/sh/news/activities/trajnim-ne-lidhje-me-perdorimin-e-google-classroom/1596;]</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mesimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> | <p>Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mesimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë edhe individë me eksperiencë në biznes dhe administratë publike, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit. Eksperienca e tyre u shërben për të demonstruar në auditor raste reale të lidhura me fushën e studimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Sipas RVB, personeli akademik në KUB plotëson formularin e anketave vetëvlerësuese që kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Gjithashtu rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mesimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur. Gjatë vizitës në KUB GVJ konstatoi se personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi merr në konsideratë kërkesat e studentëve për të ofruar një eksperiencë mesimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Stafi akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik ku reflekton dhe përmirësimin e formave e metodave të mesimdhënies.</p> <p>[Vizita në institucion: Takim me studentët; Stafin Akademik të Programit;]</p> <p>[Dokument nga vizita në institucion: Anketa E Studentit Për Lëndën Dhe Pedagogun E Përditësuar; Formatit I Pyetësorit Të Studentit I Plotësuar;]</p> |
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p> | <p>Personeli akademik ofron ambiente online ose fizike që lejojnë interaktivitet duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | [Vizita në institucion: Takim me Stafin Akademik të Programit; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] | | | |
| Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Ofrimi i ambienteve online ose fizike që lejojnë realizimin e laboratorëve detyrave, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Mësimdhënësit janë të pranishëm gjatë laboratorëve detyrave, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura të cilat realizohen pas përcjelljes së informacionit teorik nga ana e mësimdhënësit. GVJ konstatoi respekt të ndërsjellë ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve gjatë vizitave në institucion. [Vizita në institucion: Takim me Stafin Akademik të Programit; dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | GVJ pas vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. [Shenimet gjate vizites, Beder; dok DVV Evidenca nr. 51 Marrëveshje me kompaninë Albpastrim për mirëmbajtjen e ambienteve të KU "Beder"] |
| Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | GVJ pas vizitës në ambientet e dedikuara për procesin mësimor, konstaton se ambientet janë të pajisura me sistem ngrohjeje, laboratorët mësimore janë të pajisur me kompjutera dhe projektorë. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente (smart board) të cilat bëjnë të mundur zhvillimin me cilësor të procesit mësimor. |
| Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme | Personeli akademik dhe studentët e KUB përdorin sistemin IT të zhvilluar Beder Information System (BIS). Instucioni ka një marrëveshje me Google për përdorimin e platformën G-Suite. Sipas RVB, raportimi për mësimdhënien në distancë është realizuar me anë të platformës on.beder.edu.al. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton gjithashtu se personeli akademik dhe studentët e KUB përdorin infrastrukturë të |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>për realizimin e procesit mësimor.</p> | <p>konsoliduar IT të nevojshme për procesin mësimor: rrjet kompjuterik profesional; akses per internet tabela inteligjente; kompjutera; projektore; akses online në bibliotekë JSTOR etj.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)] [dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)] [dok DVV Evidenca nr. 52 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite]</p> |
| <p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbështetet procesi mësimor në programin Bachelor në Teknologji Informativ dhe Komunikimi garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Duke qënë se programi i studimit Bachelor në Teknologji Informativ dhe Komunikimi formon specialist në një fushë në zhvillim shumë të shpejtë ka veshtirësi në gjetjen e literaturës në gjuhën shqipe, literatura më e fundit për këtë program është kryesisht në gjuhë të huaj. Literatura është e ruajtur fizikisht në bibliotekë. Literatura në gjuhën angleze është në formë elektronike. Gjatë vizitës stafi akademik u shpreh se studentët kishin njohuri të mira të gjuhës angleze. Literatura e lëndës u jepet studentëve në formë elektronike që në leksionin e parë.</p> <p><i>GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekës me tekste në gjuhën shqipe, në mbështetje të programit të studimit.</i></p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR; GVB; Vizita në institucion:Stafi Akademik]</p> |
| <p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> | <p>KU "Beder" disponon në bibliotekën fizike një numër të madh titujsh e botimesh. Biblioteka është e pajisur me tavolina, karrige, kompjutera, Wi-Fi dhe vihet në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës. Biblioteka e KU "Beder" ka kapacitet 24 poste leximi dhe 8 kompjutera në funksion të saj. Në Bibliotekën fizike gjenden 22.600 tituj shkencor, 26.000 libra shkencor, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore.</p> <p>[dok DVV RVB Shtojca nr. 6: Tedhena te plota per platformat on line Struktura e teknologjise se informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); Vizita në Institucion]</p> |
| <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p> | <p>KU "Beder" në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies i ka ofruar personelit akademik dhe studentëve mundësinë e aksesimit në bibliotekën digjitale JSTOR. Kjo librari aksesohet lehtësisht me anë të llogarisë mail të institucionit.</p> <p>[dok DVV RVB Shtojca nr. 6: Tedhena te plota per platformat on line Struktura e teknologjise se informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR]</p> |
| <p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se Kolegji Universitar "Beder" vë në dispozicion të studentëve dy laboratore informatike për realizimin e laboratorëve, detyrave të</p> |

| dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | kursit, diplomave dhe studimeve specifike të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi. [dok DVV RVB; Vizita në institucion] | | | | | | | | |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|--|
| Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | KU "Beder" përdor platformën G-Suite për të ofruar shërbime kundrejt stafit dhe studentëve. G-Suite siguroi vazhdimësinë e pandërprerë të procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Platforma G-Suite ofron ndër të tjera video-konferenca, klasa virtuale, prezantime, teste ose quize on-line, detyra dhe vlerësime për to etj. [dok DVV Evidenca nr. 52 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite] | | | | | | | | |
| Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Platforma G-Suite që përdoret nga institucioni ofron ndër të tjera email dhe hapësirë pa limit drive duke mundësuar akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar për personelin akademik, administrativ dhe studentët. Secili nga studentet në momentin e regjistrimit pajiset me një adresë emaili në formatin (iniciali i emrit, mbiemri, viti i regjistrimit @beder.edu.al). Stafi akademik dhe administrativ është i pajisur me adresë emailin në formatin (iniciali i emrit, mbiemri (@beder.edu.al). [dok DVV Evidenca nr. 52 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite] | | | | | | | | |
| Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Departamenti i Shkencave Kompjuterike përcakton personelin akademik për udhëheqjen e diplomave. Studentëve pasi zgjedhin udhëheqësin e tyre të diplomës, u ofrohet një listë me tematika studimi, dhe marrin nga udhëheqësi udhëzimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të temës. [dok DVV Evidenca nr. 55 Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, viti akademik 2020-2021] | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X | |
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | X | | | | | | | |

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe | Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) në KUB organizon dhe drejton përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



| | |
|---|--|
| bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | komunikohen individualisht personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. [dok DVV përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;] |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Stafi akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit i cili dorëzohet në njësinë bazë, përpara se të vlerësohen më tej nga eprorët e tyre. Departamenti i Shkencave Kompjuterike, është në monitorim të cilësisë për lëndët e ofruara nga programi edhe nëpërmjet anketës së lëndëve që plotësohet nga studentët. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. [dok DVV Evidenca nr. 56 Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik] [dok DVV Evidenca nr. 46: Anketa e studentit ndaj lende] |
| Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | KUB inkurajon bashkëpunimin dhe ndarjen eksperiencës personeli i tij akademik dhe jo vetëm. Duke pasur eksperiencë në ofrimin e programeve të edukimit dhe komunikimit ka qënë i mundur eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimdhënies. [dok DVV Evidenca nr. 49 Lista e trajnimeve për stafin; Evidenca nr. 58 Lista e trajnimeve për kërkimin shkencor] [dok DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër] |
| Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | GVJ konstaton se KUB mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Nga data 9 shtator 2019 deri në datën 30 shtator 2019, çdo të premte, në orën 10:00, ndër trajnime të tjera KUB ka organizuar trajnimin “Kërkimi shkencor si domosdoshmëri akademike” nga (Dr. William Karl Martin). [dok DVV Evidenca nr. 58 Lista e trajnimeve për kërkimin shkencor] |
| Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | GVJ konstaton se KUB mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Nga data 9 shtator 2019 deri në datën 30 shtator 2019, çdo të premte, në orën 10:00, ndër trajnime të tjera KUB ka organizuar trajnimet: “Teknologjia në ndihmë të mësimdhënies cilësore në universitet” nga (Dr. Sofokli Garo) dhe “Përditësimi i sylabuseve si nevojë në vijueshmëri nga (Dr. Ferdinand Xhaferaj). [dok DVV Evidenca nr. 58 Lista e trajnimeve për kërkimin shkencor] |
| Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies | Personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Personeli akademik angazhohet për implementimin e metodave të reja. Siç rezultoi nga takimi me stafin dhe |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe implementimin e metodave të reja. | studentët, ata aplikojnë marrjen e feed-back nga studentët pas paraqitjes së programit dhe mënyrës së organizimit dhe implementimit të tij. [dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020; Vizita në institucion; modulet e trajnimit “Teknologjia në ndihmë të mësimdhënies cilësore në universitet” nga (Dr. Sofokli Garo) dhe “Përditësimi i sylabuseve si nevojë në vijueshmëri nga (Dr. Ferdinand Xhaferaj)] | | | |
| Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | KUB organizon herë pas here trajnime për personelin akademik dhe personelin ndihmës akademik për metodat e reja në mësimdhënie. Sipas RVB, pas marrjes së trajnimeve të përvitshme për stafin, fillon aplikimi i metodave të reja dhe rezultatet e pritshmëritë diskutohen në mbledhjet e departamentit. [dok DVV Evidenca nr. 49 Lista e trajnimeve për stafin; Evidenca nr. 58 Lista e trajnimeve për kërkimin shkencor] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të KU "Beder" dhe rregulloren e programit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi". Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e sylabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet sistemit BIS. [dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore; dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]. [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e | Nga RVB dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se syllabuset e lendeve rúhen nga titullari i lëndës/modulit në sistemin BIS dhe studentët mund t'i shohin ato pas logimit në sistem, ku mund të marrin informacion mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Keto informacione ju |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | komunikohen gjithashtu studentëve ne fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës. [Vizita në Institucion] | | | |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndermjetem, niveli i pjesëmarrjes ne seminare, detyra e kursit (projekte), Quize, provimi perfundimtar. [dok DVV Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 100; Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



| Standardi III.6 | |
|--|--|
| Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | GVJ konstaton se në rregulloren e KUB është përcaktuar se ‘Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore; pjesëmarrjes; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve’. Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për të në syllabusin e saj. [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] [dok DVV Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 78, pika 5] |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Referuar evidencës [dok DVV Evidenca nr. 43 Udhëzim mbi mësimdhënien në distance] , forma kryesore e testimit elektronik është Google Forms. Nëpërmjet Google Forms testi mund të realizohet me alternativa dhe vlerësimi i studentit të behet ne menyre automatike nga sistemi. Secili nga studentët mund të marrë ne menyre individuale tezen dhe automatikisht vlerësimin e tij, bashkë me çelësin e pergjigjeve. KU "Beder" disponon gjithashtu sistemin e brendshem BIS ku bëhet komunikimi individualisht dhe ruajtja e vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej | Referuar evidencës [dok DVV Evidenca nr. 59 Shembull, organizimi i provimeve finale] , KU "Beder" realizon testimin e vlerësimi e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale me 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës ose modulit. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|---|
| tyre është titullari i lëndës/modulit. | |
| Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Në dokumentin e dorëzuar nga institucioni ku përcaktohen rregullat për organizimin e provimeve, nuk përcaktohet zhvillimi në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim i provimeve. Testimi i vlerësimit të njohurive, bëhet në ambiente të cilat vëzhgohen gjithmone nga së paku dy lektorë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, ndërsa të tjerët anëtarë të stafit akademik të departamentit. [dok DVV Evidenca nr. 60 Rregulla per organizimin e provimeve] |
| Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Sipas RVB vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente dhe feedback nga pedagogu. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre. Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Nga vizita në KUB dhe RVB në rastet e nevojshme, lektori është i gatshëm të bëjë sqarimet e nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë. |
| Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Referuar RVB dhe takimeve në institucion të gjitha detyrat e kursit dhe projektet kontrollohen për plagjiaturë me anë të platformave falas dhe pa pagesë. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit. |
| Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Nga vizita në institucion u mor informacioni se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve në KUB bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. |
| Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Gjatë vizitës në institucion studentët dhe stafi akademik u shprehën se nëse studentët kishin pakënaqësi në lidhje me vlerësimin komunikonin direkt me pedagogun. Gjithashtu studentët mund të paraqesin një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore në rast se vazhdojnë të jenë të pasqaruar apo të pakënaqur me vlerësimin [dok DVV Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te pare, neni 24] |
| Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Sipas RVB, ankimimi shqyrtohet nga nje komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo me shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit. Gjatë vizitës në institucion GVB u shpreh |






| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | se ka pasur raste ankimimi nga studentët për vlerësimin dhe këto raste janë trajtuar duke ngritur komisione rivlerësimi. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, GVJ konstaton se synohet formimi i ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Bazuar në kurrikulën e tij dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta, programi synon zhvillimin e dijeve të studentëve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi zhvillon aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Nëpërmjet këtij programi studentëve u jepen aftësitë teknike të kërkuara në treg për specialistë IT. [dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;] |
| Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, institucioni siguron informacion mbi cilësinë e aftësive që ata fitojnë. Gjithashtu vetë institucioni, realizon një analizë të provimeve përfundimtare dhe të rezultateve të studentëve, për të monitoruar kalueshmërinë, cilësinë, frekuentimin etj. |
| Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të | Sipas RVB, studentët marrin udhëzime konkrete nga stafi akademik për format e implemetimit të njohurive dhe aftësive të fituara në lëndë të ndryshme nëpërmjet praktikave profesionale në kompani apo |





| | |
|---|---|
| rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | institucione të ndryshme. Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, ata u shprehën se në javën përpara testit ndërmjetës dhe në javën e 15 përpara testit final pedagoget bëjnë një përmbledhje të njohurive kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët mbi strukturën e testit ndërmjetës dhe atij final. [Vizita në institucion] |
| Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | GVJ konstaton se personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Për vitin 2020-2021, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka hartuar një plan aktivitetesh, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe leksione dhe seminare jashtë strukturës së programit të studimit. Në këto aktivitete janë zhvilluar edhe webinarë online apo seanca demonstruese mbi aplikime teknologjike. [dok DVV Evidenca nr. 22 Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021] |
| Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | GVJ vlerëson se personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike së bashku me studentët. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Studentët aplikojnë njohuritë e marra gjatë lëndëve në praktikat profesionale [Vizita në Institucion; Dokument nga vizita Lista E Praktikave_Studentet E TIK] |
| Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, personeli akademik i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Përgjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Gjatë vitit akademik 2019-2020 studentët kanë realizuar nën kujdesin e stafit akademik dhe prezantuar projekte në grup. [dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020] [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Vizita në Institucion] |
| Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e | Detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të lëndëve në programin Bachelor në Teknologji Informacionin dhe Komunikimi, krijojnë |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| shkencore dhe mbështetje të studentëve. | klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative. [dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informati dhe Komunikimi; Vizita në Institucion] | | | |
| Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Gjatë vitit akademik 2019-2020 studentët e programit Bachelor në Teknologji Informati dhe Komunikimi kanë realizuar nën kujdesin e stafit akademik dhe prezantuar projekte në grup të bazuara në idetë e tyre inovative. Në planin strategjik të KUB një zë të veçantë ka rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore. [dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020]. [dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023] | | | |
| Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Sipas RVB, janë ndërtuar ura ndërlidhëse komunikimi dhe bashkëpunimi me Universitetin e Tor Vergata ne Itali me në fokus shkëmbimin e eksperiencave akademike dhe mbështetjen e shkëmbimeve të lektorëve dhe të studentëve. Realizimi i shkëmbimit të eksperiencave nuk ka qënë i mundur gjatë dy viteve të fundit akademike për shkak të situates së krijuar nga pandemia. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.8


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Në Rregulloren Themelore të KUB përcaktohet se studentët mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, në varësi të pragut të notës mesatare. Bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit në përputhje me programin e arsimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programet e ciklit të parë. Programi i ciklit të parë Bachelor në Teknologji Informati dhe Komunikimi këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





| | |
|---|---|
| | [dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore;] |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | <p>KUB ka hartuar një manual për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë. Sipas Rregullores themelore të KUB, punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programet e ciklit të parë. Ky program këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. Sipas RVB, Kolegji Universitar "Beder" ben te mundur berjen publike te informacioneve rreth provimeve finale ose mbrojtjes se diplomave sipas rregullores. Udheheqesit e diplomave jane aktoret kyç ne percjelljen e këtij informacioni. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka përcaktuar stafin akademik për udhëheqjen e diplomave apo provimin final për këtë vit akademik.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 55 Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, viti akademik 2020-2021]</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 62 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë]</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore; neni 88]</p> |
| Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | <p>Programi i ciklit të parë Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunkimi në Kolegjin Universitar Bedër këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. Akoma nuk është zhvilluar dhe administruar provim final për këtë program studimi.</p> |
| Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. | <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka përcaktuar stafin akademik për udhëheqjen e diplomave apo provimin final për këtë vit akademik i cili është viti i parë ku diplomohen e studentët e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunkimi.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 55 Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, viti akademik 2020-2021]</p> |
| Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | <p>Sipas RVB, përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës është e udhëheqesit, të cilët janë përcaktuar për këtë program studimi. Caktimi i udhëheqësve akademike nga KU "Beder", përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, etj, në fushën e punimit të temës së diplomës.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 55 Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, viti akademik 2020-2021]</p> |
| Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas | <p>KUB ka një udhëzues të miratuar për shkrimin e temës. Sipas RVB, caktimi i udhëheqësve akademike nga KU "Beder", përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, shkrimin e temës, në fushën e punimit të temës së diplomës si dhe garantimin e cilësisë së rezultateve dhe miratimin ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | komisionit. Udhëheqësit akademikë janë përcaktuar për studentët e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi për këtë vit akademik. Ky është brezi i parë i studentëve që diplomohen në këtë program në KUB. [dok DVV Evidenca nr. 62: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë] | | | |
| Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Sipas rregullores themelore të KUB dhe planit mësimor të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi për këtë vit akademik. Punimi apo provimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë dhe si e tillë vlerësohet me note. [dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore; Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] | | | |
| Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. | KUB, Në përfundim të studimeve, pajis studentin me diplomë formati i të cilës paraqitet në dokumentin [dok DVV Evidenca nr. 65 Diploma] . Suplementi i diplomës është dërguar në ministrinë e arsimit për miratim. [Vizita në institucion] | | | |
| Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | KUB vë në dispozicion kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar sipas kërkesës së studentëve. Një shembull i përshkrimit të lëndëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore jepet në dokumentin. [dok DVV Evidenca nr. 66 Shembull, përshkrim lëndesh nga Zyra e Sekretarisë Mësimore] | | | |
| Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | GVJ konstaton se, KUB përcakton në rregulloren e arkivës ruajtjen për një periudhë të pacaktuar të një kopje të dokumentacionit të studentit. Gjatë vizitës në KUB sekretaria i paraqiti GVJ informacion mbi studentët të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi të zgjedhur random nga GVJ. [dok DVV Evidenca nr. 67: Rregullorja e Arkives, neni 6] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

| Standardi IV.1 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar me programin Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, dhe janë krijuar dosje personeli te plota për secilin prej tyre. Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësuesin e zyrës së burimeve njerëzore u vlerësuan dosjet e personelit akademik të dy anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, përkatësisht S.G (PAE) dhe O.E (PAK). GVJ konstaton se nga kjo zyrë janë mbajtur dhe ruajtur të dhëna për angazhimin e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme), si dhe te personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrative për programin e studimit.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 68 Lista e të dhënave individuale të personelit me kohë të plotë], [Dok DVV Evidenca nr. 40 Guida e Stafit], [Dok DVV Evidenca nr. 20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] dhe Shtojcat], [Dok DVV Evidenca 21 Evidenca nr. 69 Udhëzim “Për ngarkesën mësimore”] dhe [Dok DVV Evidenca personeli akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik në Kolegjin Universitar Bedër janë rregulluar me rregullore të vecantë, në përputhje me detyrimet e akteve ligjore në fuqi. Në procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik janë të përfshirë dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, që janë përgjegjës për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” Procedurat e ndjekura për procesin e rekrutimit në Kolegjin Universitar Bedër janë përcaktuar në rregulloren dhe procedurat e rekrutimit të stafit të ri akademik.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore, Neni 26], [Dok DVV Evidenca nr. 70 Procedura e punësimit të stafit] , [Dok DVV Evidenca nr. 71 Praktika e punësimit të stafit], [Dok DVV Evidenca 21 Personeli</p> |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | akademik në Njësinë kryesore dhe Njësinë përgjegjëse], [Dok DVV Evidenca 22 Personeli akademik në programin studimit] | | | |
| Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se në rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore janë parashikuar procedura dhe kriteret të posaçme dhe specifike të punësimit të personelit akademik në programet e studimit në Kolegjin Universitar Bedër, të cilat propozohen nga drejtuesi i departamentit që mbulon programin e studimit dhe miratohen nga rektori i Kolegjit Universitar Bedër, si dhe procedura që ndiqet është e hapur nëpërmjet publikimit të vendeve vakante në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar Bedër dhe në zyrat e punës.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 72 Shembull, kerkese per Drejtorine Rajonale te punesimit, [https://www.beder.edu.al/sh/content/default/vende-te-lira-pune-13/411/656], [Dok DVV Evidenca nr. 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 35 Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit], [Dok DVV Evidenca nr. 70 Procedura e punësimit të stafit] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 71 Praktika e punësimit të stafit]</p> | | | |
| Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se në procedurën e ndjekur nga Kolegji Universitar Bedër për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik janë plotësisht të përfshirë Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, që janë përgjegjës për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqitjes së kërkesës dhe kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme për plotësimin e vakancës/vakancave në përputhje me modulet dhe përmbajtjen e programit dhe kualifikimin e personelit të kërkuar; • përfaqësimit në shumicë të departamentit që mbulon programin në komisionin ad-hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues të vakancës/vakancave; <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 35 Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit], [Dok DVV Evidenca nr. 73 Shembull, kriteret për vendetvakante] dhe [https://www.beder.edu.al/sh/content/default/vende-te-lira-pune-13/411/656]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



Standardi IV.2**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se është ndërmarrë angazhimi i duhur dhe është krijuar një mjedis dhe infrastrukturë e përshtatshme për realizimin e detyrave në mënyrë profesionale nga personeli i institucionit dhe programit të studimit në vecanti. GVJ vizitoi ambientet e Kolegjit Universitar Bedër 2 ndertesa, me një sipërfaqe funksionale afro 3500 m². Në përdorim të personelit të angazhuar me programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” janë vënë në dispozicion zyra me hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kondicionim, ndricim dhe poste të pajisura me kompjuter personal) Ngarkesa javore e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, ku përfshihen dhe angazhimet në programet e tjera të studimit lë në dispozicion të personelit akademik efektiv kohën e nevojshme për kualifikime të mëtejshme apo dhe për kërkimin shkencor.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.14 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik],[Dok DVV Shtojca Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/ Njësisë Bazë] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 51 Marrëveshje me kompaninë Albpastrim për mirëmbajtjen e ambienteve të KU “Bedër”]</p> |
| Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër në funksion të një prej objektivave kryesorë të misionit të tij ka mbështetur zhvillimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të personelit të angazhuar me programet e studimit, me trajnime të zhvilluara nga Kolegji Universitar Bedër apo në institucione të tjera, si në vend dhe jashtë tij. Ngarkesa javore e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ku përfshihen dhe angazhimet në programet e tjera mundëson kohën në dispozicion për kualifikime të mëtejshme dhe kërkimin shkencor.</p> |
| Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | <p>Gjatë takimit me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, u informuam për mbështetjen e dhënë nga Kolegji Universitar Bedër në angazhimet në konferenca dhe kurse kualifikimi, të organizuara në Kolegjin Universitar Bedër falas për personelin akademik, si dhe vënien në dispozicion të një fondi prej 750 euro për stafin akademik efektiv në funksion të kërkimit shkencor, sipas</p> |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



| | |
|--|---|
| | <p>udhëzimit përkatës të KU Bedër, si dhe të 10 ditë leje ekstra për stafin akademik, organizimin në bashkëpunim me aktore të tjera akademike për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme akademike. Kolegji Universitar Bedër ka organizuar gjatë vitit akademik 2018-2020 trajnime specifike të personelit akademik në metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja, në aftësitë në fushën e kërkimit dhe shkrimit shkencorë.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 43 Udhëzim mbi mësimdhënien në distance], [Dok DVV Evidenca nr. 49 Lista e trajnimeve për stafin] dhe [Dok DVV 16- Raporti i Zyrës së Planifikimit të Karrierës, 2016-2021], [Dok DVV Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik], [Dok DVV Evidenca nr. 40 Guida e Stafit], [Dok DVV Evidenca nr. 57 Udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite]</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se nga ana e institucionit është zbatuar parimi i angazhimit të burimeve njerëzore, personelit akademik në këtë program studimi, sipas ekspertizës në mësimdhënie dhe në fushën specifike, në funksion të përmbushjes së programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. KUB ka të miratuar në rregulloret e brendshme procedurat dhe kriteret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis stafit akademik. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin e kërkuar dhe të nevojshëm për lëndët që mbulon. Kjo duket edhe nga analiza e të dhënave të paraqitura dhe formimin e stafit përkatës siç jepet në CV-të e tyre. Ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv jepet vetëm për vitin akademik 2020-2021 dhe është vjetore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. nga 2 - 15 orë mësimore në programin e studimit; 2. nga 2 - 16 orë mësimore në programin e studimit dhe të tjera. <p>GVJ konstaton që kjo ngarkesë mundëson një proces mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësor si dhe mundësi angazhimi të personelit në projekte kërkimore ku përfitimet e kërkimeve dhe njohurive do të mund të pasqyrohen edhe në dijet e përçuara tek studentët.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.69 Udhëzim “Për ngarkesën mësimore”], [Dok DVV Evidenca 22 Personeli akademik në programin studimit], [Dok DVV Evidenca nr.20 CV e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi], [Dok DVV Evidenca Nr.14 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në një vit akademik] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 40 Guida e Stafit]</p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi IV.3


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse. Megjithëse këtë vit akademik mësimi është zhvilluar online, auditorët e vënë në dispozicion për pjesën teorike të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” janë të kapaciteteve të ndryshme dhe të pajisur me kompjuter, videoprojektor dhe dërrasë interaktive.</p> <p>[Dok DVV Shtojca Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/ Njesisë Bazë]</p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse. Auditorët, klasat, laboratorët, biblioteka, sallat e leximit, si dhe ambientet e tjera në funksion të mësimdhënies - mësimnxënies të programit të studimit janë të pajisura me pajisje elektronike (kompjuter, videoprojektor dhe dërrasë interaktive) dhe janë të mbështetura me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Wi-Fi të Kolegjit Universitar Bedër; • Dy salla laboratorësh të pajisur me kompjuter (mbi 50 kompjutera) me akses në intranet dhe internet. • Platformen Google G-Suite <p>Të gjitha ambientet mbështeten nga infrastruktura qëndrore dhe e hostuar TIK që administrohen të gjitha nga personeli TI i Kolegjit Universitar Bedër.</p> <p>[Dok DVV Shtojca Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/ Njesisë Bazë], [Dok DVV Evidenca nr. 75 Specifikime teknike për laboratorin e</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




| | |
|--|--|
| | kompjuterave] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 52 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite”] |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit, 2 laboratorë me videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi, si dhe mbi 25 kompjutera me performance te larte për secilin laborator, me akses në intranet dhe internet me shpejtesi te konsiderueshme, të cilat mirëmbahen nga personeli TI i Kolegjit Universitar Bedër. Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Wi-Fi të Kolegjin Universitar Bedër.</p> <p>[Dok DVV Shtojca Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/ Njësisë Bazë] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 75 Specifikime teknike për laboratorin e kompjuterave]</p> |
| Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion 2 laboratorë me mbi 25 kompjutera secili me akses në një rrjet të përbashkët dhe internet. Në këto laboratore janë të instaluar një disa programe të licensuar dhe disa open source.</p> <p><i>GVJ rekomandon se softuerët e përdorur në laboratorë, të cilët nuk janë të mjaftueshëm për mbështetjen e pjesës laboratorike të këtij program studimi, në përputhje me kërkesat e lëndëve të programit të studimit, duhet të përditësohen në përputhje me programet e azhurnuara të lëndëve.</i></p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 75 Specifikime teknike për laboratorin e kompjuterave]</p> |
| Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni në mbështetje të programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” i ka kushtuar vemendje te vecante praktikave profesionale, te programit te studimit, ne ambjentet e KU Beder, si dhe bashkëpunon në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet perkatese. Në të njëjtën kohë ka caktuar një përfaqësues pranë zyrës së Planifikimit të Karrierës në mbështetje për përzgjedhjen e institucionit ku do të zhvillohet praktika profesionale dhe ndjekjen e zhvillimit te tyre. Kolegji Universitar Bedër ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi dhe nën thirrjet për projektin ERASMUS +, për personelin akademik dhe studentë në shume Universitete.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 75 Specifikime teknike për laboratorin e kompjuterave], [Dok DVV Evidenca IT COMP lista e kompanive per</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | praktika], [Dok DVV Evidenca nr. 26 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU], [Dok DVV Evidenca nr.25 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani dhe Kroaci] dhe [Dok DVV Erasmus+ Inter-Institutional Agreement_University College Beder] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi IV.4



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton që biblioteka është e lokalizuar në katin e tretë, me një sipërfaqe 119 m², në dispozicion të studentëve, përfshire dhe të programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, gjatë orarit 9.00-19.00, me 24 poste leximi dhe 8 poste kopjuterash. Në të njëjtën kohë, si salla leximi për këtë program përdoren dhe ambiente të tjera, përfshirë sallat e seminareve, të pajisuara me kompjutera dhe ku ofrohet akses i pakufizuar në internet. Ne te njejten kohe disponohet dhe aksesi ne librarine online JSTOR ne dispozicion dhe te ketij programi studimi.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.42 Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës], [Dok DVV Shtojca Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/ Njesisë Bazë], [Dok DVV Shtojca tabela 17 Te dhena te plota per platformat online/Struktura e teknologjise se Informacionit/Biblioteka/Biblioteka online] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR]</p> |
| Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër GVJ konstaton se në bibliotekën e institucionit per programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” disponohet literatura e plote kryesisht për lëndët e formimit bazë dhe nje pjese tjeter ndihmese ne gjuhen angleze kryesisht literatura e rekomanduar.</p> <p>Pjesa më e madhe e literaturës në gjuhën angleze është siguruar nga abonimi në librarinë online JSTOR, me abonim vjetor qe rinovohet e fundit deri me Shtator 2021, me përdorim të kufizuar vetëm për studentët e institucionit. Studentëve të programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” u është vënë në dispozicion literatura për lëndët e programit dhe nëpërmjet</p> |


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|---|
| | <p>platformave “G-Suite for Education” dhe “OnE Beder Online Education” dhe/ose nëpërmjet komunikimit elektronik.</p> <p><i>GVJ rekomandon se është e nevojshme që në vazhdim të pasurohet literatura fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.</i></p> <p>[Dok DVV Shtojca Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/ Njesisë Bazë], [Dok DVV Shtojca tabela 17 Te dhena te plota per platformat online/Struktura e teknologjise se Informacionit/ Bibloteka/Bibloteka online] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se për studentët e programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ofrohet shërbimi falas dhe me akses të barabartë nëpërmjet abonimit ne Bibloteken online JSTOR dhe ne Book Academic Collection, me të drejtë abonimi të kufizuar në intranetin e institucionit.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR]</p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se për studentët e programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ofrohet shërbimi falas dhe me akses të barabartë nëpërmjet abonimit ne Bibloteken online JSTOR dhe ne Book Academic Collection, me të drejtë abonimi të kufizuar në intranetin e institucionit. Ne te njejten kohe disponohen 8 poste kompjuterike per shfrytezimin e literatures elektronike.</p> <p>[Dok DVV Shtojca tabela 17 Te dhena te plota per platformat online/Struktura e teknologjise se Informacionit/ Bibloteka/ Bibloteka online] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR]</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se per vitin akademik 2020-2021 nga KU Beder eshte vene ne dispozicion te Departamentit te Shkencave Kompjuterike, per literaturen e re te programeve te studimit, fondi prej 1000 Euro.</p> <p><i>GVJ rekomandon se institucioni duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” sipas nevojave dhe kerkesave per kete program studimi.</i></p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 53 Projekt buxheti i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021]</p> |




| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve shërbimet e bibliotekës çdo ditë gjatë orarit 8.30-19.00 dhe ne sezon provimesh dhe gjate fndjaves. Në të njëjtën kohë ambienti i bibliotekës mund të shfrytëzohet si sallë leximi nga 24 studentë dhe 8 poste kompjuterike. Ne te njejten kohe eshte vene ne funksion dhe sistemi online i regjistrimit te studenteve dhe rezervimit te literatures, nje modul i ri i sistemit te automatizimit ne KU Beder. Në faqen web të Kolegjit Universitar Bedër mundësohet kërkimi në fondin e titujve që disponon biblioteka.</p> <p>[Dok DVV Shtojca tabela 17 Te dhena te plota per platformat online/Struktura e teknologjise se Informacionit/ Biblioteka/Biblioteka online], [Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 54 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR] dhe [http://library.beder.edu.al]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> | |

Standardi IV.5



Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit, dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon dhe ka në përdorim sistemin e automatizimit BIS qe realizon dhe administron te gjitha veprimtarite ne institucion, ne menyre te automatizuar. Ne kete sistem te gjitha njesite e KU Beder jane te pajisura me nje llogari nepermjet se ciles kryejne te gjitha aktivitetet. Ne BIS jane te ruajtur rekordet per stafin adminitrativ, akademik dhe student. Ne menyre te vecante per studentet ruhen dhe gjurmohen te dhenat e aktivitetit te studenteve te programve te studenit te KU Beder.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)]</p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton që KU Beder nepermjet sistemit te informacionit te</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





| | |
|--|--|
| <p>akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>automatizuar (BIS) dhe sipas moduleve perkatese te tij administron dhe gjurmon informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin per:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentet; |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Stafin akademik; • Zyrat e stafit administrativ; • Partneret bashkepunues; <p>Duke u siguruar akses te dedikuar ne informacion dhe dokumentacion ne proceset e perfshira.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)]</p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka në perdorim per komunikimin e personelit administrativ me studentet sistemin e automatizuar (BIS). Nderkohe për realizimin dhe administrimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve ka ne perdorim platformat “G-Suite for Education” dhe “OnE Beder Online Education”. Studentëve të programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, u është vënë në dispozicion literatura për lëndët e programit te studimit. Me anë të moduleve të dedikuara të këtyre platformave mundësohet komunikimi i personalizuar, në kohë reale në platformë mes pedagogëve dhe studentëve. Në këtë platforma organizohet dhe administrohet procesi, materialet dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve nga pedagogu në funksion të zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Informacioni administrohet në formë të personalizuar për çdo përdorues, pedagog apo student.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)] dhe [Dok DVV Shtojca tabela 17 Te dhena te plota per platformat online/Struktura e teknologjise se Informacionit/ Bibloteka/Bibloteka online]</p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> | <p>GVJ konstaton që Sitemi i Automatizuar BIS mundeson dhe ofron monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe mundësimin e gjenerimit të raportimeve individuale të personelit akademik dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët direkt nga sistemi. GVJ evidentoi gjenerimin ne sistem te te dhenave te studenteve qe kane regjistruar lendet ne nje semester te caktuar si dhe mangesite e evidentuara per ato qe nuk jane regjistruar.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)]</p> |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni ka në funksion platformën e faqes zyrtare Web, një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit,</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | fakulteteve, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar azhurnohet në mënyrë të vazhduar dhe për momentin është në dy gjuhë shqipe dhe angleze. [https://www.beder.edu.al/en] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në shqyrtimin e DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jo-fitim prurës dhe si i tillë një mbështetje e madhe janë donacionet. Institucioni ka hartuar një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe një plan për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi 2018-2021, ku shihet që ka siguruar të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programit të studimit. [Dok DVV Evidenca nr. 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Raporti Vjetor Institucional 2019-2020] dhe [Evidence Te ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit – Tabela 18] |
| Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se harton planin në nivel institucional dhe jo sipas programit të studimit, ku janë përfshirë të gjitha të ardhurat dhe financimet e ndryshme, kryesisht donacione si dhe shpenzimet operationale. Në raportin vjetor institucional 2019-2020, ku në Financimin dhe Menaxhimin e Burimeve është paraqitur pasqyra e buxhetit afatmesëm (2018-2021) të parashikuar dhe realizuar që të ardhurat kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër” vijnë nga arkëtimet e studentëve nga dhe për shkollimin, si dhe një pjesë nga donacionet. [Dok DVV Raporti Vjetor Institucional 2019-2020] |

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni pasi ka kryer auditimin e përvitshëm ka vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar ne raportin vjetor 2019-2020 ku ka paraqitur planin 3 vjecar (2018-2021) dhe realizimin 1 vjecar (2019-2020), ku paraqitet informacioni ne rang institucioni per te ardhurat nga tarifat per shkollimin si dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>[Dok DVV Raporti Vjetor Institucional 2019-2020] dhe [Evidence Te ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit – Tabela 18]</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton nga pasqyrat financiare të raportuara per planifikimin buxhetor për vitet 2018 - 2021 dhe të realizimit buxhetor për vitin 2019-2020, se institucioni ka patur burim të të ardhurave pagesat nga tarifat e studimit dhe pagesat e studentëve për shërbimet administrative. Disbalancat e përkohshme të krijuara në diferencat midis të ardhurave e shpenzimeve janë financuar nga donacionet. Menaxhimi i shpenzimeve tregon aftësinë e institucionit për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në vazhdim, për institucionin në përgjithësi dhe në vecanti për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.</p> <p>[Dok DVV Evidence Raporti Vjetor Institucional 2019-2020] dhe [Dok DVV Evidence Te ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit – Tabela 18]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |




| | | | | |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura që duhet të ndjekë për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” që janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe të përcaktuara në Rregulloren e Institucionit, rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, si dhe rregulloren e veçantë të Programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, politikat specifike janë të detajuara në rregulloren përkatëse dhe bëhen publike në udhëzuesin e studentit.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë], [Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 41 Guida e Studentit]</p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura për të garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët e programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, që mbështeten në Statusin e Institucionit, Rregulloren e institucionit, rregulloren e Fakultetit të Informacionit dhe Inovacionit, si dhe rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.</p> <p>GVJ konstaton që në Kolegjin Universitar Bedër hartohen dhe zbatohen politika dhe procedura mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara, si ambjente dhe mjete te nevojshme dhe zbritje nga tarifa e studimeve deri ne 100 %. Kjo ndihmë në formë burse u ofrohet dhe studentëve të programit të studimit për vitet 2018-2021:</p> <ol style="list-style-type: none"> 15 nga studentët e regjistruar në vitin 2018-2019 kanë përfituar bursë në masën 15-100 %; |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|--|---|
| | <p>2. 13 nga studentët e regjistruar në vitin 2019-2020 kanë përfituar bursë në masën 5-100 %;</p> <p>3. 7 studentët e regjistruar në vitin 2020-2021 kanë përfituar bursë në masën 30- 80 %;</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, neni 20]</p> |
| <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konfirmon se në zbatim të politikave dhe procedurave, institucioni ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore (faqja zyrtare si dhe platformën BIS), për publikimin e kriterëve dhe procedurave të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe diplomimit të studentëve të programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Kriteret dhe procedura e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, broshurat informuese, si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në Institucion.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 35], [Dok DVV Evidenca nr. 36 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”], [Dok DVV Evidenca nr. 41 Guida e Studentit], [https://www.beder.edu.al/sh/news/other/ditet-e-informimit-te-maturantëve-5/1626] dhe [https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-8-1/6/151]</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion. GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimit nenit 5 të Rregullores se Programit ka përcaktuar kriteret specifike të pranimit të studentëve në Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për pranimin janë publikuar në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar Bedër dhe në sistemin U-Albania sipas udhëzimeve të MASR por edhe në faqen zyrtare të institucionit</p> |
| <p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> | <p>Kriteret e veçanta për vitin akademik 2020-2021 janë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mesatarja aritmetike minimale e shkollës së mesme 6.5, e cila përfshin edhe provimet e maturës, në vlerësimin për nxjerrjen e aplikantëve fitues zë masën 70 %. • Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, zë masën 30 %. <p>Ne faqen web të institucionit jepen edhe kriteret e pranimit për studentët e huaj krahas atyre vendas. Në të njëjtën kohë këto kriterë dhe kuotat e studimit u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit, në faqen web, si dhe në aktivitetet informuese të organizuara nga IAL për maturantët nëpër rrethe. Pranimi në këtë cikël studimesh realizohet përmes portalit U-Albania.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 36 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”] dhe [https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-8-1/6/151]</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ ka konstatuar se institucioni përpara fillimit të vitit akademik ka informuar dhe udhëzuar publikun dhe studentët e interesuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në programin e studimit nëpërmjet informimit në faqen Web të institucionit, fushata informuese në shkollat e mesme në qytete të ndryshme, panireve, broshurave të informimit, si dhe informimit të publikut të interesuar dhe në zyrat dhe ambientet e institucionit. Këtë vit janë organizuar përgjatë muajit Mars 2021 “Ditët e Informimit të Maturantëve” për shkak të kufizimeve nga pandemia, në takime informuese në platformën Zoom.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, neni 5], [Dok DVV Evidenca nr.36 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”], [Dok DVV Evidenca nr.77 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”] & [https://www.beder.edu.al/sh/ content/ default/pranimet-ne-bachelor-8-1/6/ 151]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi V.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka vënë në</p> |



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> | <p>dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik në faqen e internetit, në kontratën e studentit, në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti, me pjesëmarrjen e stafit akademik që mbulon programin në fjalë, në broshurën “Guida e studentit” si dhe gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabusit të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të mësimit.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, neni 5],[Dok DVV Evidenca nr.41 Guida e Studentit], [https://www.beder.edu.al/sh/news/other/ditet-e-informimit-te-maturanteve-5/ 1626] & [https://www.beder.edu.al/shcontent/default/pranimet -ne-bachelor-8-1/6/151]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni në zbatim të Udhëzimit Nr.18, datë 21.05.2019, të ndryshuar të MASR, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë dhe rregullores së programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Në këto rregullore përcaktohet që procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet e ciklit të pare ndiqen nga komisioni përkatës, i ngritur nga njësia bazë dhe që studentët duhet të ndjekin jo më pak se dy semestra studime pranë fakulteteve të Kolegjit Universitar “Bedër”. Në këtë program studimi nuk ka patur transferime te studimeve.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të pare],*[Dok DVV Evidenca nr.12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi], [Dok DVV Evidenca nr.79 Vendimi për ngritjen e Komisionit për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Studentëve], [Dok DVV Evidenca nr.80 Rregullorja e Transferimit të Studimeve] dhe [Evidencë Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit të studimit, në mënyrë të përgjithshme për infrastrukturën në dispozicion të programit të studimit që në javën e orientimit, nëpërmjet broshurës “Guida e studentit” dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës ku paraqitet ky informacion. Në të njëjtën kohë ky informacion u bëhet i njohur studentëve në llogarinë e tyre në sistemin e informacionit të automatizuar BIS, ku bëhet e njohur informacioni në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të gjithë lëndëve dhe ecuria e tyre përgjatë gjithë periudhës së studimeve. GVJ në</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të pare], [Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi], [Dok DVV Evidenca nr.41 Guida e Studentit], [Dok DVV Evidenca nr.39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi][Dok DVV Evidenca nr. 59 Shembull, organizimi i provimeve finale] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 19 Shembull syllabusi CMP 111 Hyrje ne algoritem dhe programim]</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve rregulloren themelore dhe të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, kjo dhe nëpërmjet broshurës “Guida e studentit”. Diplomimi organizohet në varësi të zgjedhjes së studentit me provim ose me temë diplome. Një model suplementi diplome është dërguar për miratim në MAS.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të pare], [Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi], [Dok DVV Evidenca nr. 41 Guida e Studentit], [Dok DVV Evidenca nr. 62 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të pare], [Dok DVV Evidenca nr. 63 Formatu zyrtar i institucionit për punimin e diplomës], [Dok DVV Evidenca nr. 64 Shembull, formular i vlerësimit të punimit të diplomës për programin Bachelor] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 65 Diploma]</p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni publikon dhe informon mbi programin e studimit, Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” në faqen zyrtare të internetit të institucionit, në panairë të karrierës në qytete për maturantët si dhe broshurave gjatë ditëve të informimit të maturantëve. Në vijim të traditës së krijuar në Kolegjin Universitar Bedër, gjatë “Ditëve të Informimit të Maturantëve”, përgjatë muajve Mars - Prill, këtë vit janë organizuar takime me maturantët dhe të interesuarit në muajin Mars 2021, për shkak të kufizimeve nga pandemia, në takime informuese në platformën Zoom. Në të njëjtën kohë këto kriteret dhe kuotat e studimit u janë komunikuar studentëve dhe para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit.</p> |

| | | | | |
|------------------------------------|--|----------------------|---------------------|----------------------|
| | [Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, neni 5], [Dok DVV Evidenca nr. 41 Guida e Studentit], [https://www.beder.edu.al/sh/news/other/ditet-e-informimit-te-maturanteve-5/ 1626] dhe [https://www.beder.edu.al /shcontent/ default/ pranimet-ne-bachelor-8-1/6/151] | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.3



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Ky informacion është i publikuar i plotë në faqen web dhe në sistemin e informacionit të automatizuar BIS. Në javën e parë të orientimit, në zbatim të rregullores së programit të studimit, krahas prezantimit të programit të studimit, me të gjithë elementët nga përgjegjësi i departamentit dhe personeli përkatës, realizohet prezantimi i objektivave dhe njohurite dhe aftësitë e fituara nga secila lëndë. Në javën e parë të mësimin në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë e parashikuara formuese. Ky informacion u bëhet i ditur studentëve edhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 41 Guida e Studentit], [Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi], [Dok DVV Evidenca Plani mësimor i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] dhe [https://cmp.beder.edu.al/sh/ content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi -19/616/617]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen</p> | <p>Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Planifikimit të Karrierës, u konstatua se nëpërmjet këshilltarit për planifikimin e karrierës të emëruar nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike informohen</p> |


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> | <p>studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillohen, mbështeten dhe orientohen, për tregun e punës dhe janë mbështetur dhe këshilluar për përgatitjen e CV, letrave të motivimit, përgatitjen për intervistë punësimi. Studentët gjatë këtij viti akademik janë udhëzuar dhe kanë përfituar nga marrëveshjet me institucione private dhe shtetërore për praktika mësimore.</p> <p>[Dok DVV 16- Raporti i Zyrës së Planifikimit të Karrierës, 2016-2021], [Dok DVV Evidenca nr.23 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës], [Dok DVV Evidenca nr. 24 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 29 Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale]</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme (broshura si Guida e studentit), faqe Web, sistemi i automatizuar BIS mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit. Që në javën e parë të orientimit studentët njihen me kalendarin akademik, orarin mësimor, ambientet, mjetet dhe shërbimet në funksion të programit të studimit, dhe u është caktuar nga departmenti dhe asistohen nga këshilltari akademik që mbështet një grup të caktuar studentësh.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 24 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik], [Dok DVV Evidenca nr. 41 Guida e Studentit], [Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 37 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informativ dhe Komunikimi], [Dok DVV Evidenca Plani mësimor i programit Bachelor në Teknologji Informativ dhe Komunikimi] dhe [https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617]</p> | | | |
| <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p> | <p>GVJ konstaton se informacioni i nevojshëm në lidhje me programin e studimit është lehtësisht i aksesueshëm dhe ju vihet në dispozicion studentëve të programit të studimit në disa forma: nëpërmjet faqes web, nëpërmjet sistemit të automatizuar BIS dhe nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar nga sekretaria mësimore.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)] dhe [https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |




Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> | <p>GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. U konstatua se në zbatim të rregullores të zyrës së sekretarisë mësimore, kjo zyrë administron dhe ndjek regjistrimin e studentëve, përfshirë dhe të programit të studimit. Nga ana e sekretarisë mësimore të institucionit mbahen dhe përpunohen dhe të dhëna në formë statistikore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programet e studimit. Në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informati dhe komunikimi” janë të regjistruar për vitet 2018-2021, 42 studentë, nga të cilët janë të pritje të diplomimit 17 studentë të brezit të parë. Sipas të dhënave tabelore në RVB, tabelës nr. 21 numri i studentëve për tre vitet akademike është:</p> <p>Viti 2018-2019 20 studentë gjithsej; Viti 2019-2020 15 studentë gjithsej; Viti 2020-2021 7 studentë gjithsej;</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 82 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore], [Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 76 Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore] dhe [Evidencë Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>GVJ konstaton se siç u cilësua dhe në kriterin e parë, institucioni disponon të dhëna vjetore për studentët e programeve të studimit, ku për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informati dhe Komunikimi” ka pasur 3 të larguar për vitin 2018-2019 dhe 2 studentë të larguar për vitin 2019-2020.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 82 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore], [Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 76 Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore] dhe [Evidencë Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni regjistron dhe disponon të dhëna në sekretarinë</p> |

| | |
|---|---|
| <p>studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> | <p>mësimore për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit nga pranimi, deri në përfundim të studimeve, për brezin e parë të këtij programi studimi duke filluar nga viti akademik 2018-2019. Këto të dhëna statistikore përpunohen në sistemin e automatizimit BIS dhe përdoren nga Kolegji Universitar Bedër, fakulteti apo departamentit për analiza të ndryshme. Ndërkohë të dhënat e vlerësimit të studentëve i kalojnë dhe hardcopy për administrim në arkive Sekretarisë mësimore.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr.76 Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore][Evidencë Mesataret hyrese dhe ne vazhdim ne TIK] dhe [Evidencë Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve]</p> |
| <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>GVJ konstaton se, për menaxhimin e informacionit të brendshëm të plotë të aktivitetit akademik të studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe për këtë program studimi dhe përpunimin e të dhënave statistikore kanë në përdorim sistemin e automatizimit të informacionit BIS, në të cilin kanë akses dhe menaxhohen me përdorues me role specifike të dhënat e studentëve.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 76 Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore][Evidencë Mesataret hyrese dhe ne vazhdim ne TIK] dhe [Evidencë Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve]</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar për vitet 2018-2021 për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, raport analitik mbi profilin, cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe nivelin dhe cilësinë e punësimit të tyre, si dhe masat që janë marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve të matur të programit të studimit. Nga ana e departamentit të shkencave kompjuterike cdo vit akademik i caktohet këshilltari akademik një grupi studentësh, me detyra të përcaktuara në rregulloren mbi organizimin akademik, i cili ka një llogari me akses specifik në BIS për komunikim me studentët dhe mbështetjen dhe ndjekjen e përparimit akademik dhe mundësisë së punësimit për secilin prej tyre. Departamenti i Shkencave kompjuterike ka organizuar aktivitete të ndryshme me bashkëpunëtorë të ndryshëm për të krijuar kontaktet me tregun e punës, në funksion të praktikave profesionale dhe rritur mundësinë e punësimit të studentëve, këto të publikuara dhe në raportet vjetore të vetë departamentit, Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe të institucionit. Në brezin e parë të programit të studimit, viti 2018-2019 janë të regjistruar aktualisht 20 studentë, nga të cilët 4 janë punësuar të punësuar në përputhje me profilin e diplomës. Në brezin e dytë të programit të studimit, viti 2019-2020 janë të regjistruar aktualisht 15</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>studentë, nga të cilët 3 janë të punësuar në përputhje me profilin e diplomës.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 76 Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore][Evidencë Mesataret hyrese dhe ne vazhdim ne TIK], [Dok DVV Evidencë Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve], [Dok DVV Evidenca nr. 27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite] dhe [Dok DVV Evidencë Studentë të punësuar me kohë të pjesshme]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.5



Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> | <p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren themelore, ku specifikohet qartë parashikimi i përfshirjes dhe angazhimit, si dhe roli i studentëve të zgjedhur nga Këshilli studentor që marrin pjesë dhe angazhohen në organet vendimmarrëse e këshilluese si Senati akademik, Njësia SBC dhe komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë. Në Kolegjin Universitar Bedër është ngritur Dekani i Studentëve një ndër detyrat kryesore që ushtron është mbarëvajtja e marrëdhënieve të studentëve me institucionin.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni ka garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren themelore, si dhe rregulloren e anketave dhe vlerësimeve, ku përfshihen dhe vlerësimin e studentin</p> |



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|--|---|
| <p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>për personelin akademik. Studentët e zgjedhur nga këshilli studentor janë përfaqësues të studentëve përkatësisht në senatin akademik, komisionet e perhershme, këshillin e etikës dhe në NjBSC.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr.7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 45 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 83 Shembull, listëprezenca e përfaqësuesit të studentëve në mbledhje]</p> |
| <p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar planin mësimor të përgatitur për programin e studimit Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, në zbatim të akteve ligjore dhe rregullatore duke mbajtur në fokus ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi sipas përcaktimeve. Në Kolegjin Universitar Bedër një mjet efikas për eliminimin e procedurave burokratike dhe vonesave administrative, sistemin e automatizimit të informacionit BIS, ku studentët dhe personeli i institucionit të përfshirë kanë akses dhe informacionin e nevojshëm për ndjekjen e përparimit akademik. Sic e përmendëm dhe më lart për vitet 2018-2021 nuk ka pasur kërkesë për transferime apo njohje të pjesshme apo të plota në këtë program studimi.</p> <p>[Dok DVV VKM Nr.41, datë 24.01.2018 e ndryshuar] dhe [Dok DVV Evidencë Plani mësimor i programit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben pyetëtori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. Ky pyetësor menaxhohet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe analiza e rezultateve i shkon Rektorit, i cili duke e përcjellë në Departament, urdhëron të përpilohet plani i masave përkatëse.</p> <p>Në programin e studimit, Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është realizuar proces përmirësimi i këtij programi efektiv për vitin akademik 2019-2020, një shkëmbim vendesh të dy lëndëve në fushën e programimit.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 89 Udhëzimi mbi procesin e Zhvillimit të Kurrikulave], [Dok DVV Evidenca nr. 38 Praktika e ndryshimit në kurrikul],[DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020] dhe [Dok DVV</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | Evidenca nr. 83 Shembull, listëprezenca e përfaqësuesit të studentëve në mbledhje] | | | |
| Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se institucioni u mundëson studentëve së pari vënien në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, në javën e informimit dhe gjatë javës së parë të mësimit për çdo lëndë. Studentëve ju mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij me anën e një kërkesë në Zyrën e sekretarisë mësimore sipas rregullores përkatëse “Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të pare”. | | | |
| | [Dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të pare] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 12 Rregullorja e programit Bachelor ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për priëjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët



| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | GVJ konstaton se institucioni ka krijuar strukturën e zyrës së Dekanit të Studentëve, e cila u siguron studentëve mbështetjen, burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Dekani i studentëve pranon kërkesat e tyre çdo ditë dhe kërkesat vlerësohen nga strukturat përkatëse. Zyra e dekanit të studentëve informon me e-mail studentët për vendimin në lidhje me kërkesën e tyre. Në të njëjtën kohë informimi dhe shërbimi i studentëve mbështetet dhe nga zyra e ngritur për këtë qëllim, Zyra e Planifikimit të Karrierës, zyra e sekretarisë mësimore, sekretaria e departamentit të shkencave kompjuterike dhe keshilluesi akademik. [Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 82 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore], [Dok |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|--|
| | <p>DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 23 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>Institucioni ka të ngritur zyrën e Planifikimit të Karrierës tërësisht në mbështetje të informimit, këshillimit, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme që nga regjistrimi. Në të njëjtën kohë me vendim departamenti, për cdo vit akademik caktohet një këshilltar akademik për cdo program studimi. Këshillatri akademik mbështetet nga sistemi i automatizuar i informacionit BIS, në punën e tij. Në të njëjtën kohë Zyra e Planifikimit të Karrierës në bashkëpunim me departamentin e shkencave kompjuterike kanë mbështetur studentët e programit të studimit me praktikat profesionale dhe pjesëmarrjen në aktivitete dhe leksione të hapura me shumë interes profesional.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja mbi Organizimin Akademik], [Dok DVV Evidenca nr. 24 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 29 Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>Institucioni nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës, ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Në këtë Zyrë cdo Departament ka një këshilltar për planifikimin e karrierës, të cilët ofrojnë konsulencë për studentët që nga dita e regjistrimit. Këshilltari i karrierës informonon studentët për aktivitete të ndryshme të organizuara në Institucion dhe jashtë tij, ku mund të marrin pjesë studentët, kërkon për mundësi punësimi, si dhe jep mbështetjen dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë dhe në të njëjtën kohë këshilltari akademik ndjek ecurinë e procesit mësimor në mënyrë të vazhdueshme, duke i orientuar studentët qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor, por dhe në orientimin dhe zgjedhjen e praktikës profesionale, si dhe orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës dhe mbështetjen dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë. Në të njëjtën kohë nga aktorët e mësipërm ofrohet dhe mbështetja e nevojshme për gjetjen dhe zhvillimin e praktikave profesionale në listën e institucioneve bashkëpunuese ekzistuese ose gjetjen e bashkëpunëtorëve të rinj në fushën TIK.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja mbi Organizimin Akademik], [Dok DVV Evidenca nr. 24 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik], [Dok DVV Evidenca nr. 23 Vendimi i Këshillit</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës],[Dok DVV Evidenca nr. 22 Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021] dhe [Dok DVV Evidenca 16- Raporti i Zyrës së Planifikimit të Karrierës, 2016-2021] | | | |
| Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstaton se zyra e Planifikimit të Karrierës, si pjesë të detyrave të saj ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit. Kjo zyrë përgatit raporte periodike në lidhje me punësimin e studentëve, trajnimin e tyre dhe mundësitë e reja të punësimit dhe ua paraqit studentëve dhe organeve drejtuese në institucion. Krahas saj në Kolegjin Universitar Bedër është ngritur Zyra e të Diplomuarve, në varësi të Dekanit të Studentëve, e cila administron dhe përpunon të dhënat për të diplomuarit dhe punësimin e tyre. Kjo zyrë mban kontaktet afatgjata me studentë dhe oragnizon aktivitete të ndryshme që konsistojnë kryesisht në: <ol style="list-style-type: none"> 1. Bedër ALUMNI; 2. Takim mes brezash, qe organizohet në rang departamenti; 3. Takim mes të diplomuarve; Në bazën e të dhënave, nuk ekzistojnë të dhënat e studentëve të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” pasi këtë vit diplomohet brezi i parë i këtij programi studimi dhe për momentin disponohet vetëm informacion për disa studentë që punojnë me kohë të pjeshme. <p>[Dok DVV Evidenca nr.16 Rregullorja Themelore], [Dok DVV Evidenca nr.33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr.27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite] dhe [Dok DVV Evidenca nr.29 Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>KUB ka krijuar struktura dhe miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit. Misioni i arsimit të lartë është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane. Një ndër funksionet e Senatit Akademik është të vlerësojë dhe garantojë sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion. Kolegji Universitar Bedër ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një strukturë e përhershme, si dhe 2 komisione të përhershme (Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin dhe komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit), përbërja, të drejtat, detyrat dhe funksionimi i komisioneve të përhershme, përcaktohen nga Senati Akademik në rregulloret përkatëse.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 7 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Kreu II, Neni 9], [Dok DVV Evidenca nr.10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]. [Dok DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit] dhe [http://qac.beder.edu.al/]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>GVJ konstaton se IAL ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një strukturë e përhershme dhe komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Njësia funksionale e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Kolegjin Universitar Bedër zbaton strategjinë e miratuar të institucionit që ka në fokus kryesor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë në këtë proces ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të studentëve.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme], [Dok DVV Evidenca nr. 33 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit] dhe [http://qac.beder.edu.al/]</p> |

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

GVJ konstaton se IAL ka hartuar dhe miratuar rregulloren për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, bazuar në përcaktimet ligjore në fuqi për kodin e cilësisë, i cili përmban dhe përshkruan të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me mënyrën e vetëvlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë në kuadër të Fakulteteve dhe të KUB. NJSBC në funksion të detyrës për garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bazuar në rregulloret e IAL-së përdor instrumentat të ndryshme kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit, angazhimit të ekspertizës së jashtme dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara. Kolegji Universitar Bedër ka realizuar 2 akreditime institucionale përkatësisht në 2013 (APAAL-6 vjet) dhe 2017 ("Quality Assurance Agency" dhe ASCAL -4 vjet). IAL ka përdorur si mjet vlerësimi analitik dhe krahasues të rregulluar me rregullore të vecantë procesin e anketimit dhe vlerësimit që garanton mbledhjen e informacionit/të dhenave, krahasimin dhe vlerësimin e tyre në funksion kryesisht rregullimit të procesit të vlerësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. NJSBC, që varet direkt nga rektori ndjek dhe koordinon proceset e vlerësimit të brendshëm të institucionit dhe përgatit raportin përkatës të vetëvlerësimit, rezultatet e të cilave bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit që publikohet dhe në faqen web të KUB.

[Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit], [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme], [Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca Tabela 24 të dhëna për anëtarët e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 45 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] dhe [<http://qac.beder.edu.al/>]

Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Kolegji Universitar Bedër ka hartuar një politikë të qartë për të ndjekur në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë procedura periodike që garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e programeve të studimeve, në këtë rast Bachelor ne "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi". NJSBC ka përdorur instrumentat e duhura në zbatim të strategjisë dhe rregullores të miratuar të NJSBC, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit, ngritjes së komisioneve ad-hoc, analizave vjetore të cdo departamenti, takimeve të zhvilluara me palët e interesuara si dhe raporteve të ndryshme vetëvlerësimi. NJSBC koordinon dhe organizon 2 herë në vit, në mënyrë anonime, para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë dhe program studimi, përfshirë edhe programi i studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Kolegji Universitar Bedër në planin strategjik të miratuar 2018-2023, ka në fokus përmirësimin në fushat kryesore mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri, duke i dhënë vëmendje të vecantë vlerësimit dhe mjeteve matëse efikase. Për këtë arsye janë hartuar plane veprimi për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit në komunitet.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 86 Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm 2019], [Dok DVV Evidenca nr.45 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve], [Dok DVV Evidenca nr. 46 Anketa e studentit ndaj lëndës], [Dok DVV Evidenca nr. 47 Anketë, mësimdhënia në distancë], [Dok DVV Evidenca nr. 88 Anketë vlerësimi e stafit akademikadministrativ ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca nr. 84 Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit] dhe [Dok DVV Evidenca anketa e studentit për lëndën dhe pedagogun e përditësuar]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi VI.2 | |
| Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një njësi të posaçme me funksion të përhershëm e cila është funksionale dhe është përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e programeve të studimit. Në të njëjtën kohë IAL ka ngritur dhe komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Funksioni dhe detyrat e tyre janë përcaktuar në statutin e IAL dhe rregulloret përkatëse. Këto struktura në zbatim të udhëzimeve të manualit të sigurimit të cilësisë përdorin mekanizma e procese të formalizuara të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit, përfshirë dhe Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, në zbatim rregullores së miratuar të NJSBC, sipas një plani, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit, komisioneve ad-hoc dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara. NJSBC organizon 2 herë në vit, në mënyrë anonime, |
| Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. | |

| | |
|---|---|
| | <p>online, para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetsorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë program studimi, përfshirë edhe programin e studimit. NJBSC përgatit dhe vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar, raportin e vlerësimeve periodike në procesin e shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit. Në fund të vitit departamenti përgjegjës për programin e studimit ka realizuar procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së këtij programi. Rezultatet e vlerësimit dhe sipas rasteve të identifikuar për përmirësim përkthehen në rekomandime për tu zbatuar dhe monitoruar më tej për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e ecurisë së këtij programi.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Evidenca nr. 45 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve], [Dok DVV Evidenca nr. 46 Anketa e studentit ndaj lëndës], [Dok DVV Evidenca nr. 47 Anketë, mësimdhënia në distancë], [Dok DVV Evidenca nr. 88 Anketë vlerësimi e stafit akademikadministrativ ndaj institucionit],[Dok DVV Evidenca nr.84 Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca anketa e studentit për lëndën dhe pedagogun e përditësuar], [Dok DVV Evidenca nr. 86 Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm 2019] dhe [http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=24]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër ka përdorur metodologji vlerësimi dhe instrumente të vlerësimit të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë dhe programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. NJBSC ka organizuar aktivitete për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor në bashkëpunim me komisionet e përhershme, dhe grupeve ad-hoc të ngritura pranë departamenteve, të publikuara dhe në faqen web të KUB, si kalendari i NJSBC.</p> <p>Analiza e anketimeve shërben për vlerësimin dhe orientimin e programit të studimit drejt nevojave të tregut të e tregut shqiptar dhe atij ndërkombëtar.</p> <p>Rezultatet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga NJBSC tek drejtuesit e departamenteve, fakulteteve dhe rektoratit të Kolegjit Universitar Bedër dhe jepen dhe rekomandimet përkatëse për tu zbatuar, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë NJBSC. Në të njëjtën</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>kohë në përfundim të cdo viti realizohet dhe vlerësimi i personelit akademik, rezultati i të cilit i njoftohet personelit akademik, në mënyrë personale, në një zarf të mbyllur.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informatik dhe Komunikim], [Dok DVV Evidenca nr. 46 Anketa e studentit ndaj lëndës], [Dok DVV Evidenca nr. 47 Anketë, mësimdhënia në distancë], [Dok DVV Evidenca nr. 88 Anketë vlerësimi e stafit akademik administrativ ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca nr. 84 Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca anketa e studentit për lëndën dhe pedagogun e përditësuar], [Dok DVV Evidenca nr. 86 Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020],[Dok DVV Evidenca nr.87 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm],[Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm2019] & [http://qac.beder.edu.al/pages.php?s = 42]</p> |
| <p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegjit Universitar Bedër dokumenton rezultatet e vlerësimeve, sipas përcaktimeve të Rregullores së NJSBC-së dhe manualit të sigurimit të cilësisë. NJSBC duhet ti dërgojë tek autoritetet përgjegjëse dhe vendimmarrëse të programit të studimit. Raporti i rezultateve të nxjerra nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga NJSBC tek titullari i lëndës, drejtuesi i departamentit, dekani, së bashku me rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë NJSBC.</p> <p>Dok DVV Evidenca nr. 45 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve], Dok DVV Evidenca Manual i sigurimit të cilësisë], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 87 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm] dhe [Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm 2019]</p> |
| <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> | <p>Kolegji Universitar Bedër për aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit, sipas udhëzimeve të manualit të sigurimit të cilësisë ka përgatitur raporte të cilat përmbajnë rezultate të vlerësimit, masat e marra për adresimin e mangësive të identifikuara dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tyre. GVJ konstaton që IAL ka publikuar rezultatet e anketimeve në faqen web të KUB.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Manual i sigurimit të cilësisë], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 87 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm] ,[Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm 2019],[http://qac.beder.edu.al/ pages.php?s=9] & [http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=24]</p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër realizon vlerësimin e brendshëm periodik të programit të studimit, Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, nga NJBSC në nivel institucional, me mbështetjen e grupit ad-hoc të departamentit që mbulon programin e studimit, të cilat janë pjesë e procesit të vetëvlerësimeve të kryera në kuadër të akreditimeve apo vetëvlerësimet e brendshme periodike. Kolegji Universitar Bedër gjatë vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, si dhe mjete specifike, në përputhje me specifikat e fushës së programit të studimit. Një instrument shumë efektiv i përdorur është përfshirja e studentëve në proceset e vlerësimit në nivel lënde të programit të studimit. Vlerësimi i studentëve është objekt diskutimi dhe vlerësimi në nivel departamenti duke propozuar dhe zbatuar përmirësimet e nevojshme. Përmirësimet e propozuar të kurrikulave realizohen në koordinim me Zyrën për zhvillimin e Kurrikulave sipas udhëzimit përkatës të IAL. Një instrument tjetër i përdorur nga IAL është prezantimi i hapur i raporteve vjetore të departamenteve të përgatitura nga vetë njësitë, duke mundësuar shkëmbimin e eksperiencave dhe realizuar përmirësimin e kërkuar. Nisur nga këto gjetje dhe nevoja për përmirësim apo monitorim, në cdo fillim viti akademik përgatitet plani i aktiviteteve të njësisë bazë për vitin e ri akademik.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Manual i sigurimit të cilësisë], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 22 Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021], [Dok DVV Evidenca nr.38 Praktika e ndryshimit në kurrikul] dhe [Dok DVV Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”]</p> |
| <p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.

Bedër, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, nëpërmjet njësave përkatëse NJBSC dhe komisionit të përhershëm për sigurimin e standarteve dhe cilësisë dhe sipas udhëzimeve të manualit të sigurimit të cilësisë ka organizuar dhe koordinuar punën në përdorimin e metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për realizimin e vlerësimit si më poshtë:

1. Vrojtime në orët mësimore në auditor;
2. Vrojtime gjatë kryerjes së praktikës;
3. Pyetsorët e studentëve për programin e studimit, mësimdhënia;
4. Rezultatet e studentëve nga vlerësimi i detyrave apo projekteve individuale apo në grup;
5. Rezultatet e studentëve në testet ndërmjetëse dhe përfundimtare të lëndëve të programit të studimit dhe në praktikat profesionale të studentëve;
6. Rezultatet e studentëve në provime të lëndëve të programit të studimit të vlerësuara me nota dhe pikë;
7. Rezultatet e studentëve në provimin përfundimtar të formimit/diplomës të programit të studimit.

[Dok DVV Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”], [Dok DVV Evidenca Manual i sigurimit të cilësisë], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJBSC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020],[Dok DVV Evidenca nr. 46 Anketa e studentit ndaj lëndës], [Dok DVV Evidenca nr. 47 Anketë, mësimdhënia në distancë], [Dok DVV Evidenca nr. 88 Anketë vlerësimi e stafit akademikadministrativ ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca nr. 84 Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca anketa e studentit për lëndën dhe pedagogun e përditësuar], [Evidenca nr. 27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite], [Evidenca nr. 28 Përshkrim rreth Konkursit Kombëtar të IT-së],[Evidenca nr. 59 Shembull, organizimi i provimeve finale], [Evidenca nr. 64 Shembull, formular i vlerësimit të punimit të diplomës për programin Bachelor] & [<http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=9>]

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit ka përdorur metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të tilla si sondazhet për vlerësimin e mësimdhënies, të lëndëve/moduleve, si dhe të nxenit në programin e studimit. Raportet e rezultateve të vlerësimit nga sondazhet të përgatitura nga NJBSC i

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> | <p>raportohen drejtuesit të departamentit, dekanit të fakultetit dhe rektoratit të institucionit, si dhe në mënyrë individuale i raportohen dhe personelit akademik pjesë e procesit të vlerësimit. GVJ konstaton që për vitet 2018-2021 për programin e studimit, pjesë e procesit të vlerësimit kanë qenë personeli akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, dhe jo aktorët e tjerë të rekomanduar si ekspertë të jashtëm profesionistë të fushës. Për këtë është i nevojshëm një studim i ri i departamentit për nevojat dhe kërkesat e reja të tregut të konsultuara dhe në funksion të përmirësimeve të nevojshme të këtij programi studimi.</p> <p>[Dok DVV Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”], [Dok DVV Evidenca Manual i sigurimit të cilësisë], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020],[Dok DVV Evidenca nr. 46 Anketa e studentit ndaj lëndës], [Dok DVV Evidenca nr. 47 Anketë, mësimdhënia në distancë], [Dok DVV Evidenca nr. 88 Anketë vlerësimi e stafit akademikadministrativ ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca nr. 84 Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca anketa e studentit për lëndën dhe pedagogun e përditësuar], [Evidenca nr. 27 Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite] dhe [Evidenca nr. 28 Përshkrim rreth Konkursit Kombëtar të IT-së]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi VI.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p> | |
| <p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër, ka parashikuar dhe përfshirë në zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Në zbatim dhe të rregullores përkatëse, pjesë e NJSBC janë pjesë e personelit të brendshëm akademik me eksperiencë, ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të këshillit studentor. Në të njëjtën kohë IAL ka ngritur dhe komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë, organ kolegjal, që kryen funksione, në fushat e garantimit të</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




| | |
|--|--|
| | <p>standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit, të rregulluara me rregulloore specifike për këtë strukturë.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit],[Dok DVV Evidenca Manuali sigurimit të cilësisë] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër, ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për NJSBC-në, njësitë, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programve të studimit, përfshirë dhe Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” duke garantuar përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrave. Në nivel institucioni përgjegjës të këtij procesi të rëndësishëm janë senati akademik, rektori, NJSBC, komisioni i përhershëm, grupet ad-hoc, grupet e vlerësimit të brendshëm, dekani si dhe studentët. Detyrat e tyre janë të mirëpërcaktuara në nismat për konkretizim në planin strategjik institucional me objektiv madhor sigurimin e cilësisë të procesit mësimor në programet e studimit, përfshirë dhe Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, si dhe kërkohet pjesëmarrja aktive në propozimin, përcaktimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modeleve vlerësuese sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>[Dok DVV Evidenca 7 Statuti Kolegji Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr.90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit], [Dok DVV Evidenca Manuali sigurimit të cilësisë] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]</p> |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër ka përfshirë dhe aktivizuar personel akademik të brendshëm dhe të jashtëm me eksperiencë si pjesë e NJSBC dhe Komisionit të përhershëm të garantimit të standarteve dhe cilësisë, si dhe përfaqësues të këshillit studentor të përzgjedhur në një proces të bazuar në vlerat më të mira dhe tërësisht transparent. Këta</p> |



| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|--|
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>aktorë të brendshëm janë pjesëtar aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programi studimi. GVJ konstaton që përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.</p> <p>Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit], [Dok DVV Evidenca Manuali sigurimit të cilësisë] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme] dhe [Dok DVV Evidenca Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| <p>Standardi VI.5</p> | |
|--|--|
| <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>Kolegji Universitar Bedër, ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji transparente, në lidhje me organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit SBC për programet e studimit, të cilat janë publike në faqen web të KUB.</p> <p>Institucioni nuk ka bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të SBC për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.</p> <p>[Dok DVV Evidenca 7 Statuti Kolegji Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit], [Dok DVV Evidenca Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe [http://qac.beder.edu.al/]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Programi në fjalë është në akreditim për herë të parë dhe RVJ nuk është e publikuar në faqen e IAL. Gjithashtu IAL bën publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësoreve duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat publikohen dhe në faqen web të KUB. Aktorët e interesuar njihen me këto raporte</p> |


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|---|
| | <p>përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentave.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi] & [http://qac.beder.edu.al/]</p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër, në raportet e përgatitura për SBC, pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit, ka evidentuar një plan masash që duhet të ndërmerren nga grupet dhe aktorët e përfshirë dhe interesuar për të arritur objektivin e përmirësimit të mangësive të identifikuar.</p> <p>Rezultatet e marra nga procesi i vlerësimit periodik janë përdorur jo vetëm për vlerësimin e procesit dhe identifikimin e problematikave, por edhe me objektiv marrjen e masave për përmirësimin e garantimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit, përfshi dhe Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Disa nga masat e propozuara dhe të marra në drejtim të përmirësimit të cilësisë janë: trajnimet e vazhdueshme mbi metodat e sukseshme didaktike në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në aktivitete dhe projekte zhvilluese edhe jashtë institucionit, në vend dhe jashtë.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 22 Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021], [Dok DVV Evidenca nr. 86 Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 87 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm] dhe [Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm 2019]</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër, ka vlerësuar dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit, përfshi dhe Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Ky proces vlerësimi dhe monitorimi nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të përmendur më lart ka objektiv kryesor sigurimin e efektivitetit të masave të marra për përmirësimin e mangësive dhe problematikave të identifikuar gjatë procesit të vlerësimeve të brendshme apo të jashtme dhe siguron përmirësimin e cilësisë të programeve të studimit, përfshi dhe atë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.</p> |




| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| | <p>Dok DVV Evidenca nr. 86 Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor], [Dok DVV Evidenca Raporti i NJSBC 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 87 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm], [Dok DVV Evidenca Raport i auditit të brendshëm 2019]. [Dok DVV Evidenca nr. 30 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020], [Dok DVV Evidenca nr. 46 Anketa e studentit ndaj lëndës], [Dok DVV Evidenca nr. 47 Anketë, mësimdhënia në distancë], [Dok DVV Evidenca nr. 88 Anketë vlerësimi e stafit akademikadministrativ ndaj institucionit], [Dok DVV Evidenca nr. 84 Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit] dhe [Dok DVV Evidenca anketa e studentit për lëndën dhe pedagogun e përditësuar]</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në Kolegjin Universitar Bedër, GVJ konstaton se Kolegji Universitar Bedër, ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në veprimtaritë informuese për ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit ne terma afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, përfshi dhe Bachelor ne “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në NJBSC dhe pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces akreditimi, në javën e orientimit në fillim të vitit akademik dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetësorëve të studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon se institucioni duhet të organizojë veprimtari periodike me personelin dhe studentët për ti informuar për nevojën e ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programet e studimit, përfshi dhe Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.</i></p> <p>[Dok DVV Evidenca 7 Statuti Kolegji Universitar Bedër], [Dok DVV Evidenca nr. 10 Plani Strategjik 2018-2023], [Dok DVV Evidenca nr. 48 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së], [Dok DVV Evidenca nr. 90 Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit], [Dok DVV Evidenca Manuali sigurimit të cilësisë], [Dok DVV Evidenca nr. 45 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] dhe [Dok DVV Evidenca nr. 85 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informatik dhe Komunikim”

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
2. Programi i studimit është inovativ dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës;
3. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik;
4. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit është në përputhje me fushën e ekspertizës së personelit akademik;
5. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit;
6. Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë;

b. Pika të dobëta:

1. Personeli akademik me kohë të plotë nuk mbulon 70% të ngarkesës mësimore në të gjitha vitet akademike sipas akteve ligjore në fuqi;
2. Numri i kufizuar i teksteve fizike për literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar në bibliotekë për programin e studimit dhe mungesa e një një plani të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit;
3. Softwerët e përdorur në laboratorë nuk janë të mjaftueshëm për mbështetjen e pjesës laboratorike të këtij programi studimi;

Rekomandime

1. Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore;
2. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit;
3. Pasurimi sipas një plani të detajuar të teksteve në gjuhën shqipe dhe angleze të bibliotekës, në mbështetje të programit të studimit;
4. Të sigurohen në institucion softuerët e nevojshëm për mbështetjen e pjesës laboratorike të këtij programi studimi;
5. Të publikohen dhe përditësohen në faqen zyrtare të IAL-së informacioni dhe dokumentacioni për studentët e programit të studimit dhe të interesuarit në faqen zyrtare të IAL-së, duke

respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke iu përmbajtur legjislacionit për të dhënat personale;

6. Institucioni duhet të organizojë veprimtari periodike trajnuese dhe informuese me personelin dhe studentët për rritjen e ndergjegjësisimit të tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programet e studimit;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Information and Communication Technology"

a. Strengths and affirmations:


1. Appropriate facilities and modern didactic infrastructure available to study program provides the necessary modern spaces and conditions for education process;
2. The study program is innovative and in compliance with labor market requirements;
3. The institution has developed specific mechanisms for the support and professional qualification of academic staff;
4. The assignment of study program courses is in accordance with the field of expertise of the academic staff;
5. The institution has signed new cooperation agreements in terms of academic and professional cooperation in the country and abroad;
6. The institution has created the necessary institutional mechanisms to guarantee quality;

b. Weak points:

1. Full-time academic staff does not cover 70% of the teaching load in all academic years according to the legal acts in force;
2. Limited number of physical texts for mandatory and recommended literature in the library for the study program and lack of a detailed plan for enrichment of library items in support of the study program;
3. The software in use in laboratories are not sufficient to support the laboratory part of this study program;

Recomandations:

1. Full-time academic staff must cover not less than 70% of the teaching load;
2. The institution must commit to find other sources for financing the study program;
3. Enrichment according to a detailed plan of the textbooks in Albanian and English language of the library, in support of the study program;
4. The institution must provide the necessary softwares to support the laboratory part of this study program.



5. The institution must publish and update on the official website the information and documentation for the study program students and interested parties, respecting the freedom and academic ethics and in compliance with the legislation on personal data.
6. The institution should organize periodic training and informing activities with staff and students to raise the awareness on the importance of their active participation in the quality assurance processes and continuous and long-term quality improvement in study programs.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|----------------------|---------------------|----------------------|
| | Nuk përbushen | Përbushen pjesërisht | Përbushen kryesisht | Përbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

